

INTERVISTË ME KIMETE MITROVICA BASHËN

Bruksel | Data: 25 shkurt, 2026

Kohëzgjatja: 113 minuta

Të pranishëm:

- Kimete Mitrovica Basha (E intervistuar)
- Anna Di Lellio (Kamera dhe Intervistuesja)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anna Di Lellio: Në rregull. Faleminderit, Kimete, që pranuat këtë intervistë. Kjo është Kimete Mitrovica Basha. Jemi në Bruksel. Është 25 shkurt 2026 dhe do ta bëjmë këtë intervistë në anglisht, megjithëse Kimete flet rrjedhshëm shqip, dhe ajo do të shpjegojë pse.

Kimete Mitrovica Basha: Epo, mendoj se kontakti ynë i parë ishte në anglisht, dhe ndërkohë që e di se shqipja juaj është perfekte dhe edhe e imja po ashtu, thjesht ndjeva se mënyra natyrale për të folur së bashku, që do të më bënte të ndihesha më rehat, më e çliruar me ju, është të flas në anglisht. Kështu që jam mirënjohëse ndaj jush që keni pranuar ta bëni këtë me mua. Pra po, është thjesht sepse kjo më bën të ndihem më e relaksuar, dhe të intervistohesh është e rëndësishme, por dua të jem në gjendje të shprehem pa u ndier e kufizuar. Faleminderit.

Anna Di Lellio: A mund të fillojmë nga fillimi? Ku dhe kur keni lindur, dhe a mund të na tregoni pak më shumë për familjen tuaj dhe fëmijërinë tuaj?

Kimete Mitrovica Basha: Unë isha një nga shtatë fëmijët. Jam vajza e dytë nga katër vajza me tre vëllezër. Të gjithë kemi lindur në Australi, të gjithë ne të lindur midis viteve 1952 dhe 1960, shtatë fëmijë në atë periudhë. U rritëm në një periudhë pasluftës. U rritëm në një vend që po priste refugjatë që nuk ishin nga Anglia, jo se ata ishin, e dini, por le të themi se imigracioni kishte, natyra e imigracionit në Australi në atë kohë filloi të ndryshojë, sepse deri atëherë ata pranonin në thelb vetëm britanikë. Por periudha e luftës, natyrisht, krijoi një situatë dramatike ku ata pranuan njerëz nga ish... mirë, nga vendet që do të binin pas Perdes së Hekurt.

Dhe kështu shqiptarët u pranuan, dhe prindërit e mi shkuan atje. Është një histori e gjatë pse shkuan atje, por nuk është një histori veçanërisht interesante. Dhe kështu u rritëm në një vend që kishte vështirësi të asimilonte këtë formë të re imigracioni dhe që në thelb nuk njihte çfarë ata mund të sillnin.

Kështu që prindërit e mi, të dy shumë të arsimuar, babai im me dy diploma, doktoratura, për shembull iu refuzua puna në universitet, dhe më pas u bë punëtor krahu, siç e kishte shënuar në certifikatën time të lindjes, dhe punoi në punë të ndryshme të rëndomta, gjë që çoi, sinqerisht, në përballjen e

familjes sime me përjashtimin. Unë u përballa me përjashtimin shumë herët, madje jo vetëm kaq, ishte pothuajse racizëm brutal, në fakt, dhe me këtë ndjenjë se ne në të vërtetë nuk përkisnim. Pra për mua, të rritesha në Australi, ndërsa isha një fëmijë e lumtur, isha gjithashtu dëshmitare e padrejtësive të mëdha. Dhe ajo padrejtësi në fakt ka qenë, është fara e asaj që jam bërë dhe e asaj që jam sot.

Anna Di Lellio: A mund të pyes?... siç thatë, nuk është një histori shumë interesante, por unë do të isha e interesuar të dija, si arritën prindërit tuaj në Australi si shqiptarë?

Kimete Mitrovica Basha: Po, nëna ime ishte në një kamp në fund të Luftës së Dytë Botërore. Babai im nuk ishte. Babai im, mendoj se ai bëri një zgjedhje për të mos qenë, dhe pjesërisht sepse xhaxhai i tij, nga ana e nënës së tij, Xhafer Deva, kishte qenë, kishte punuar me gjermanët. Kështu që mendoj se ishte një vendim moral për të mos shkuar në kampe. Nuk e kam pasur kurrë atë bisedë me të, kështu që nuk e di, thjesht po supozoj këtë.

Pra, në një moment, dhe unë nuk e di saktësisht se si, nëna ime dhe babai im ishin në Siri, në Damask. Pra në vitet 1948, '49, ata ishin të dy atje, dhe një grup i madh shqiptarësh ishte atje. Dhe babai im takoi nënën time, u dashurua, dhe gjashtë muaj më vonë, ata u martuan.

Pastaj refugjatët po shpërndareshin në vende të ndryshme të botës që po pranin këto komunitete dhe këta refugjatë. Fillimisht, babait tim i ishte dhënë leje për të emigruar në Amerikë. Por, dhe kështu është jeta, dhe sa e jashtëzakonshme mund të jetë ndonjëherë, babai im kishte një hernie dhe duhej të bënte një operacion. Kështu që ai e bëri operacionin.

Por ndërkohë, mundësia e tij për t'u larguar, për të shkuar në Amerikë, kishte kaluar. Ky ishte elementi i parë. Elementi i dytë ishte se babai im nuk kishte familje në mërgim. Gjyshja ime, motra e tij, etj., ishin në Shqipëri. Dhe babai i nënës sime ishte me ta. Pra, gjyshi im u dërgua në Australi. Dhe nëna ime ishte shumë e afërt me babanë e saj. Kështu që babai im, mendoj, së pari, mundësia për të shkuar në Amerikë tani ishte në pikëpyetje.

Dhe nëna ime vuante për faktin se do ta humbiste atë lidhje me babanë e saj. Kështu që babai im, mendoj se ishte një akt dashurie, vendosi: në rregull, atëherë do të shkojmë me gjyshin... le ta ketë familjen e saj, meqë unë nuk do ta kem timen. Dhe kështu ata shkuan në Australi. Mendoj... në një farë mënyre jam e lumtur që nuk shkuan në Amerikë. Por megjithatë ishte një vendim me pasoja të vështira, sepse jeta e tyre në Australi ishte shumë e vështirë, shumë, shumë e vështirë. Pra kjo është historia.

Anna Di Lellio: Ku në Australi keni lindur dhe ku keni jetuar?

Kimete Mitrovica Basha: Kam lindur në Melburn, në jug. Ishte një vend i bukur... ishte shumë britanik. Ende është qyteti më britanik nga qytetet australiane. Shumë hijerëndë, shumë konservator. Po, kam lindur në Melburn. Isha shumë e lumtur.

Dua të them, është shumë interesante, ky paradoks. Pashë aq shumë dhimbje dhe humbje. Jetoja në një komunitet mërgimtarësh, me nostalgji, mall, përjashtim, humbje identiteti. E kuptoja këtë pa e kuptuar vërtet atëherë. E ndjeja, e dini, që kishte trishtim në këtë komunitet. Por jetoja në një... në një vend të djegur nga dielli, e dini, kisha hapësirë, mund të luaja jashtë, kisha një ndjenjë të madhe hapësire, e dini, që dielli i Australisë ishte aq bujar dhe qielli aq i lartë. Dhe si fëmijë, nuk e kuptoja plotësisht. Ndjeja diçka. E ndjeja vërtet kur shikoja babanë tim të kthehej nga puna. Gjithmonë e shikoja kur kthehej nga puna.

Anna Di Lellio: Po flisim për këtë nostalgji dhe mall. Por ju keni lindur në Australi dhe si keni rënë në kontakt me kulturën shqiptare? Ju jetonit në një komunitet mërgimtarësh. Por çfarë dëgjonit? Çfarë dinit? Çfarë mësuar për kulturën shqiptare apo historinë familjare?

Kimete Mitrovica Basha: Nuk mësova shumë për historinë e familjes sime, jo deri më vonë. Por për kulturën shqiptare, ne ishim në një shtëpi shqiptare, ishim në një situatë familjeje të zgjeruar. Jetonim me gjyshërit e mi, me xhaxhain tim, gjithashtu me gjysmë-vëllanë e nënës sime dhe katër fëmijët e tij. Dhe jetonim së bashku, hanim së bashku, kishim kode, e dini, kur gjyshi im hynte në dhomë, ne ngriheshim në këmbë. Kur hanim, fëmijët hanin së bashku, dhe prindërit na shikonin, por ne ishim 11 fëmijë që jetonim bashkë në një moment, e dini, është si një komunitet i vogël.

Shqipja ishte gjuha e shtëpisë. Ushqimi shqiptar ishte ushqimi që hanim. E dini, nuk hanim fish and chips, hanim pite dhe pasul, e dini. Na mësonin kodet, e dini, na mësonin mikpritjen, mënyrën si përshëndesnim mysafirët, mënyrën si, mendoj, edhe pse kjo do të ndryshonte më vonë, na thoshin të mos flisim, të dëgjonim. Kishim përgjegjësi, edhe si fëmijë, që çdo anëtar i familjes kishte një rol për të luajtur. Nuk e di, mendoj se thjesht u ushqyem me muzikën, me gjuhën, me ushqimin, me ndjenjën e përkatësisë ndaj atij komuniteti.

Pra, isha thellësisht e rrënjosur, megjithëse, përsëri, nuk e kuptoja plotësisht këtë. Ishte, ishte, thjesht ishte. Dhe unë jetoja në harmoni të përsosur me këtë, dhe me miqësitë e mia australiane, dhe me botën jashtë. Mendoj se mësova, e kuptova herët, megjithëse mendoj se nuk do të kisha mundur ta artikuloja, se duhej të ndërtoja lidhje me atë komunitet, sepse do të kishte qenë një formë mërgimi të brendshëm nëse nuk do ta kisha bërë. Kështu që u lidha shpejt me miqësitë e mia, dhe ato u bënë jashtëzakonisht të rëndësishme për mua. Jam besnike në miqësi edhe sot, por mendoj se ato miqësi të hershme janë vërtet të rëndësishme.

Por unë jetoja... unë... Kur shkoja në shtëpi, isha vajza e mirë shqiptare. Dhe mbeta vajza e mirë shqiptare, sepse mendoj se, ndërsa rritesha, u bë e rëndësishme për mua të mos i zhgënjeja prindërit e mi, sepse ata kishin pasur kaq shumë zhgënjime. Kështu që isha një vajzë shumë e mirë shqiptare. Por unë... unë jetoja në harmoni të përsosur me botën jashtë. Është shumë interesante. Kam pasur një përvojë shumë të lumtur “shizofrenike.”

Anna Di Lellio: Po. Ju... jam kurioze, sepse flisni për babanë tuaj që ishte arsimuar në Itali, në Bolonjë, dhe unë jam italiane. Prandaj jam kurioze, si përfundoi ai atje? Çfarë ju ka treguar? A ju ka treguar ndonjë gjë për përvojën e tij në Itali?

Kimete Mitrovica Basha: Di pak për atë periudhë. Babai im, gjyshi im, Dervish Mitrovica, ishte shumë i afërt me Fan Nolin. Ishin shumë, shumë miq të ngushtë. Dhe në fakt, ekzistonte kjo ide në familje, dhe mendoj se mund të ketë një bazë të vërtetë, që Fan Noli ishte kumbari i babait tim. Ishin shumë të afërt. Dhe gjyshi im ishte i lidhur realisht me lëvizjen anti-zogiste. Kështu që ai në fakt shkoi... ai shkoi me Isa Boletinin në Tiranë, jo më 28, por më 29 [1912], sepse serbët i kishin ndaluar gjatë rrugës për në Vlorë.

Por arritën atje më 29, dhe pastaj gjyshi im ishte pjesë e qeverisë së Nolit, e kështu me radhë. Por kur Zogu erdhi në pushtet, ata shkuan në mërgim. Dhe gjyshi im shkoi në Kroaci, në Zarë, ku në fakt kishte një dyqan të vogël, dhe ky ishte një ushtarak, e dini?

Dhe babai im u arsimua në shkollat jezuite. Pastaj, mendoj se për shkak të lidhjeve kroate... si, e dini, me Austrinë dhe kështu me radhë, ai shkoi për studime, studimet e tij universitare i bëri në një universitet italian, në Bolonjë. Dhe mendoj Bolonja, sepse edhe atëherë Bolonja ishte e lidhur më shumë me mendimin përparimtar, me arsimimin liberal, e dini.

Kështu që ai shkoi... bëri... bëri një diplomë në drejtësi atje, në fakt, dhe më pas bëri studime doktore. Kështu përfundoi atje. Dhe ai ishte shumë, shumë i rrënjosur, e dini. Ju kam thënë, mendoj se ju kam përmendur në një moment që opera dhe të gjitha këto gjëra ishin pjesë e jetës sonë. Ai këndonte arie e gjëra të tilla, fliste italisht bukur, e shkruante, e jetonte, mendoj. Kishte një dashuri të madhe për vitet e tij universitare, siç kemi të gjithë, e dini.

Por kështu arriti atje, sepse gjyshi im ishte në mërgim. Dhe është qesharake, apo jo? Historia e mërgimit është një temë e përbashkët brez pas brezi. Kthehen, pastaj largohen përsëri, kthehen, dhe largohen sërish. Tani unë jam kthyer, dhe... shpresoj që të mos na duhet të mbyllim dyert përsëri, e dini. Po.

Anna Di Lellio: Kur shkuat për herë të parë në Shqipëri apo Kosovë në jetën tuaj?

Kimete Mitrovica Basha: Dua të them, hera e parë që shkova në Shqipëri ishte në prill të vitit 1991. Në dhjetor të vitit 1990, ne u kontaktuam, unë dhe burri im, Ydriz Basha¹ dhe unë, nga anëtarët themelues të lëvizjes demokratike në Shqipëri. Veton Surroi, duke ditur për aktivitetin tonë politik gjatë viteve '80, u kishte thënë atyre, kur po kërkonin ndihmë, se ka një çift në Bruksel që do t'ju mbështesë, dhe ata

¹ Ydriz (Idriz) Basha (1939–2015) lindi në Novoselj, në Shqipërinë Veriore. Ai u largua nga Shqipëria në vitin 1948, ende fëmijë, kur familja e tij u detyrua të arratisesh për arsye politike. Që nga viti 1956 jetoi në Belgjikë dhe u formua si psikoanalist në Paris. Si publicist dhe aktivist, Ydriz Basha njihet si një nga zërat kryesorë të diasporës shqiptare në Evropë gjatë viteve 1980 dhe 1990. Nga viti 1997 deri në vitin 2001, ai shërbeu si Ambasador i Shqipërisë në Belgjikë, Luksemburg dhe në Parlamentin Evropian. Në vitin 2015, atij iu akordua pas vdekjes medalja "Urdhri i Skënderbeut" nga Presidenti i Shqipërisë.

morën të dhënat tona të kontaktit. Është një histori mjaft interesante, sepse na telefonuan rreth orës një të mëngjesit, ndoshta sepse vetëm atëherë mund të siguronin lidhje, pasi lidhja telefonike ishte shumë e pasigurt.

Por telefonuan, dhe për ne ishte shumë emocionuese, e pabesueshme që, e dini, po flisnim me Tiranën, dhe ata po na kërkonin ndihmë. Dhe kështu e bëmë. Unë dhe burri im organizuam menjëherë një vizitë për delegacionin e parë të Partisë Demokratike në Paris për t'u takuar me të gjitha partitë kryesore politike atje, në thelb për të marrë ndihmë për organizimin e zgjedhjeve të para, dhe natyrisht këtu në Bruksel, në Parlamentin Evropian. Pra kjo ishte në shkurt, i sollëm në shkurt, periudhë shumë e suksesshme, shumë, shumë emocionuese. Pastaj na ftuan të shkonim në Shqipëri për kongresin e parë të Partisë Demokratike, që po mbahej në prill. Dhe kështu vizita ime e parë në Shqipëri ishte në prill 1991.

Udhëtimi im i parë në Kosovë ndodhi në vitin 2016. Ndërkohë, sigurisht, kisha takuar dhe punuar me Rugovën, dhe ai më kishte thënë, e dini, të kthehesha dhe të bëja këtë e atë. Por rrethanat ishin gjithmonë shumë të ndërlikuara, edhe për arsye familjare. Burri im ishte sëmurë rëndë dhe ishte e vështirë ta lija.

Por në vitin 2016, burri im sapo kishte ndërruar jetë. Dhe Mitrovica organizoi një lloj konference për të shënuar 100-vjetorin e lindjes së babait tim, Xhelal Mitrovica. Kështu që motra ime e madhe Lolita, vëllai im Dervish dhe unë udhëtuam për në Kosovë. Dhe kjo ishte diçka vërtet (qesh), ishte edhe më domethënëse se udhëtimi i parë në Shqipëri. Unë nuk bëra dallim... nuk bëja dallim mes Shqipërisë dhe Kosovës. U rrita në një familje dhe në një shtëpi ku nuk kishte dallim. Por diçka në të qenit në Kosovë dhe në Mitrovicë më preku thellë, vërtet shumë.

Kështu ndjeva që lidhja ime me Kosovën do të ishte më e thellë dhe më domethënëse, që do të bëja një angazhim më të madh ndaj saj. Ndjeva se historia ime nuk ishte barrë, ishte pasuri në Kosovë. Sepse në Shqipëri, sa herë përmendej Xhafer Deva, disi unë implikohesha me periudhën e pushtimit gjerman, e dini. Kështu që gjithmonë ndjeva një lloj frike nga kjo, nga gjykimet dhe implikimet...

Epo, kjo nuk ndodhi në Kosovë. Ata u angazhuan me mua në një mënyrë bujare dhe shumë respektuese. Edhe kur kishin çështjet e tyre me periudhën e Xhafer Devës, unë nuk u ndjeva e implikuar, e dini, unë nuk e kam takuar kurrë.

Anna Di Lellio: Por ju nuk shkuat atje për të festuar Xhafer Devën, shkuat për të festuar... Xhelalin tuaj.

Kimete Mitrovica Basha: Kjo është e vërtetë. Dhe kjo ishte kaq domethënëse për mua, Anna Di Lellio, sepse ju tashmë e keni ndjerë që lidhja ime me babanë tim është shumë, shumë e thellë. Kam respekt të madh për të. Përveç dashurisë, sigurisht.

Pra, të shkoja atje dhe të shihja që ai kishte rëndësi. Dhe që ai u rikthye, të paktën në psikikën time, në vendin ku duhej të ishte dhe mund të kishte qenë, në vend që të ishte ky njeri që zgjohej në orën 5 dhe

kthehej në 5 të pasdites për të ushqyer shtatë fëmijët e tij në kushte jashtëzakonisht të vështira. Unë kam... ishte kaq gëzim, kaq festë, kaq përmbushëse. Dhe ndjeva që ai ishte rehabilituar, dhe disi edhe unë bashkë me të. Pra jo, ishte një udhëtim shumë domethënës. Por ishte '91 për Shqipërinë, dhe 2016 për Kosovën.

Anna Di Lellio: Çfarë po festonin për babanë tuaj? Për çfarë roli po e festonin?

Kimete Mitrovica Basha: Thjesht ditëlindjen e tij. Dhe përmendnin që... babai im ishte gazetar dhe ishte themeluesi i Radio Prishtinës. Po, e dini, programi i parë radiofonik, ndërtesa ende ekziston.

Ai ishte, gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore, përfaqësonte Kosovën në Parlament, në parlamentin etnik. Pra ai ishte... ai vinte nga një familje shërbimi, me gjyshin tim, një përkushtim për mbrojtjen e gjuhës shqipe, integritetin territorial, të gjitha këto çështje ishin pjesë e trashëgimisë. Por pastaj, sigurisht, edhe ky angazhim antikomunist.

Pra ata po festonin njeriun dhe, mendoj, po festonin edhe familjen, por po festonin vizionin e tij për Kosovën, që sot është një çështje e debatueshme, e dini. Por mendoj se kjo ishte ajo që po bënin. Dhe ne ishim të ftuar për ta bërë këtë.

Është interesante. Kur ishim atje, vëllai im Dervish nuk flet shumë mirë shqip, e flet më mirë tani. Po flasim për 10 vjet më vonë, dhe ai e ka studiuar, është shumë i përkushtuar ta mësojë. Na pritën nga kryetari i komunës, dhe ishim ulur rreth tavolinës dhe dikush rreth tavolinës, kur Dervishi po fliste, i pëshpëriti atij pranë tij: "Shiko këtë Dervishin, nipi i Mitrovicës nuk flet shqip."

Por vëllai im e kuptonte shqipen. Dhe u kthye nga ai me një vetëbesim që më bëri shumë krenare. Dhe tha: "Unë mund të mos e flas gjuhën, dhe mund të mos jem në gjendje të komunikoj me ju në shqip, por unë jam shqiptar. Dhe jam këtu si djali i Xhelal Mitrovicës. Dhe më intereson kjo," diçka e tillë, e dini. Por ai refuzoi gjykimin. Mendova se ishte shumë e guximshme nga ana e tij, e dini. Pra ishte pak... ishte një kohë emocionuese. Kam qenë me fat. Kam jetuar kohë emocionuese.

Pjesa e Dytë

Anna Di Lellio: Në rregull, ju përmendët Xhafer Devën. A ishte ai gjyshi juaj nga ana e nënës?

Kimete Mitrovica Basha: Jo, nuk ishte gjyshi im. Ishte stërkhaxhai im. Stërkhaxhai... Gjyshja ime, Sabrija. Sabrija ishte rritur nga babai i Xhafer Devës, Ibrahim Deva. Nuk e kuptoj ose nuk më është treguar kurrë pse ndodhi kjo, por ajo u rrit si vajza e tij. Dhe kështu, sa kohë kam jetuar dhe kudo që shkoj, njerëzit flasin për Sabrijen, një gjyshe që unë nuk e kam njohur kurrë, por për të cilën kam respektin më të thellë, si motra e tij. Në fakt, ajo ishte kushërira e tij. Por unë e konsideroj veten mbesë të Xhafer Devës. Kjo është marrëdhënia ime me Xhafer Devën. Nuk e kam takuar kurrë. Nuk kam folur kurrë me të.

Por çuditërisht, ai është shumë i pranishëm në jetën time. Dhe vazhdoj të duhet të shpjegoj marrëdhënien. Shpesh kam thënë, dhe kjo e përmbledh disi qëndrimin tim, nuk do të jem avokatja e tij, por jam shumë e kujdesshme se kujt i lejoj të jetë gjykatësi i tij. Ky është pozicioni im për Xhafer Devën. Është një marrëdhënie e ndërlikuar. Ka shumë peshë. Dhe ndonjëherë në mënyrë befasuese, sepse është një paradoks, unë nuk e kam takuar kurrë. Ishte shumë larg meje. Dhe megjithatë ka kaq shumë peshë në jetën time kur jam në kontakt me kosovarë.

Anna Di Lellio: Ende, ende sot?

Kimete Mitrovica Basha: Oh, po. E dini, kur u martova, kur burri im vendosi të më marthohej, mirë, historia është e bukur, por u takuam shumë shpejt. Vendosi shumë shpejt të marthoheshim.

Anna Di Lellio: Ku u takuat?

Kimete Mitrovica Basha: Ju lutem?

Anna Di Lellio: Ku u takuat?

Kimete Mitrovica Basha: U takuam në Nju Jork. U takuam në Nju Jork. U takuam në nëntor 1977. Dhe tre ditë pasi e takova, u fejuam për martesë. Dhe ai u kthye në Evropë. Dhe më prezantoi te babai i tij, jo si mbesa e Dervish Mitrovicës, dua të them, mirë, si vajza e Xhelal Mitrovicës. Ai më prezantoi si mbesa e Xhafer Devës. Dhe me kalimin e viteve, pasi u martova, kur erdha të jetoja këtu në Belgjikë dhe u përballa me një lloj patriarkati që nuk e kisha hasur kurrë më parë, pesha e mizogjinisë ishte jashtëzakonisht e rëndë.

Ndonjëherë, fakti që ai më kishte prezantuar si mbesa e Xhafer Devës më ndihmonte shumë, sepse ndonjëherë, më falni që po e them kaq drejtpërdrejt, por i mbyllte gojën burrave. Kisha pushtet për shkak të asaj marrëdhënieje. Dhe ndonjëherë e përdorja atë.

Kam një rast interesant dhe shumë qesharak. Ishim... vetëm unë në një dhomë plot me burra, siç ndodhte shumë shpesh. Dhe ata po flisnin, po flisnin për çështjet e Kosovës. Ishin vitet '80. Dhe ne kishim qenë thëllësisht të përfshirë në krijimin, së pari, të informacionit pedagogjik apo një lloj aktiviteti këtu për të informuar, për të mësuar, e dini, publikun më të gjerë belg se ku ishte Kosova dhe cilat ishin çështjet, por edhe për të ndikuar politikën duke shkuar në Parlamentin Evropian, duke imponuar një rezolutë të parë e kështu me radhë. Unë e dija për çfarë po flisja.

Dhe ja ku jam në dhomë me këta burra që po më shpërfillnin, po më injoronin. Dhe sa herë që kisha diçka për të thënë, ata murmurisnin, "Ah, ja ku fillon prapë!" e dini. Dhe në një moment, Ydrizi e kuptoi që unë do të shpërtheja, sepse kishte raste kur mund të acarohesha shumë. Dhe për të qetësuar situatën, ai tha, "Ah, meqë ra fjala, që ta dini, kjo është Kimetja, ajo është mbesa e Xhafer Devës." Dhe të njëjtët burra që më kishin shpërfillur dhe ishin hapur përçmues ndaj meje, papritur u bënë jashtëzakonisht servilë, më sillnin ushqim, vinin e ma prisnin pulën për mua e kështu me radhë. Ishte qesharake.

Pra ndonjëherë, e dini, më hynte në punë të kisha atë pushtet mashkullor që më mbronte, e dini. Dhe ndonjëherë, në mënyrë cinike, e përdor, pse jo? E dini. A e harrova pyetjen?

Anna Di Lellio: Po, mund të kthehemi pak mbrapa sepse folëm për babanë tuaj dhe marrëdhënien tuaj me të. Po për nënën tuaj dhe gjithë ata fëmijë? Dhe gjithashtu për të, mërgimin, përvojën e mërgimit.

Kimete Mitrovica Basha: Po. Nëna ime ishte një grua me një qëndrueshmëri të jashtëzakonshme. Vërtet, ishte një model. Nuk ishte një grua e lehtë. Ajo ishte... më lejoni ta përmbledh pak. Mendoj se nëna ime e kishte jetuar rininë e saj nëpër luftë dhe kjo e kishte shënuar, e kishte bërë mosbesuese, e kishte bërë shumë private, shumë të mbyllur — gjëra që nuk thuhet, gjëra që nuk bëhen. Ishte e përkushtuar ndaj babait të saj dhe në disa mënyra mendoj se e donte atë më shumë se çdo gjë tjetër në botë, përfshirë edhe ne. Por ajo na donte siç do një tigreshë.

Kishte një instinkt mbrojtës që ndonjëherë ishte edhe i dhunshëm. Ishte e aftë për teprime. Por ndoshta ishte gruaja më besnike. (me sy të përplotur) Ishte një partnere e mirë për babanë tim. Dinë të luftonte. Dinë të mbijetonte. Dhe në këto rrethana mërgimi dhe varfërie, ajo i përballoi me guxim dhe forcë.

Pati një aksident të tmerrshëm. Shpina iu dëmtua rëndë. Duhej t'i nënshtrohej disa operacioneve shumë të vështira kur ne ishim shumë të vegjël. Dhe i thanë se nuk do të ecte më kurrë. Epo, ajo eci përsëri. U ngrit dhe eci përsëri. Aq e fortë ishte, e dini, psikologjikisht. Pastaj, 48 vjeçe, mbeti me gjashtë fëmijë në shtëpi. Motra ime e madhe ishte martuar atëherë. Babai im vdiq nga një kancer i tmerrshëm dhe vdiq brenda një viti pasi u diagnostikua. Dhe ajo e mori betejën mbi vete. Kur ai vdiq, mendoj se pati një vit vuajtjeje të madhe dhe vetmie dhe u përball me vështirësi emocionale, psikologjike.

Por ajo u rikthye dhe na rriti. Dhe bëri atë që duhej të bënte për të vazhduar punën që babai im kishte nisur me të, që ishte tema e përbashkët në shtëpinë tonë: do t'ju çojmë drejt dritës, drejt dritës. Dhe ajo e bëri këtë e vetme. Pra kur babai im vdiq, unë isha e vetmja ende në nivel universitar. Motra ime kishte mbaruar bibliotekonomi.

Ne ishim ende në fillim të diçkaje që po ndodhte dhe që do të ishte e mirë për familjen tonë, që do ta ndihmonim më shumë nënën dhe do të ndërtonim diçka më të qëndrueshme ekonomikisht për të. Por ajo ia doli. Por, e dini, ajo nuk i besonte askujt. Kishte vështirësi të mëdha me njerëzit. Nuk e di çfarë kishte ndodhur, por ajo nuk i besonte askujt.

Kjo ishte e vështirë për mua sepse unë isha kaq optimiste, dhe ende jam, idealiste. Besoj në mirësinë e njerëzve. Ajo mendonte se unë isha naive. Më kritikonte shpesh për miqësitë e mia. Mendonte se investoja më shumë se sa duhej. Dhe gjithmonë mendonte se kishte diçka transaksionale në marrëdhëniet njerëzore që unë nuk e shihja. Kështu që shpesh kishim mendime të ndryshme për

gjërat. Nuk pajtoheshja gjithmonë me vizionin e nënës sime për botën. Por mendoj se ishte instinkti i saj mbrojtës.

Por ai instinkt mbrojtës ndonjëherë bëhej shumë kontrollues. Kështu që ishte një betejë me nënën time për të mbetur ndonjëherë, jo gjithmonë, ajo nuk ishte gjithmonë e vështirë, por, e dini, dhe unë nuk isha gjithmonë në konflikt me parimet e saj. Por ndonjëherë ishte vërtet e vështirë për atë që mund të bëja dhe që nuk mund të bëja. Dhe kjo u bë veçanërisht e vështirë pasi u fejuam, sepse, e dini, isha 24, 25 vjeçe dhe ajo kontrollonte lëvizjet e mia.

Po punoja në universitet dhe ajo më thoshte: në çfarë ore do të kthehesh në shtëpi? Dhe nëse nuk isha në shtëpi në katër, ajo bëhej hysterike. Po sikur Ydrizi ta kuptojë që ke qenë jashtë? Ishte kaq e çuditshme. Por mendoj se ajo po na mbronte, por e tepronte. Kështu që kishte kufizime dhe ndalime. Kishte një frikë që... ishte e vështirë me nënën time. Por ajo, e dini, na donte me një dashuri të egër.

Dhe ajo i kapërceu vërtet të gjitha vështirësitë me forcë të madhe. Tani e admiroj shumë nënën time. Nuk e admiroja kur isha 20 vjeçe, por tani jam 70, dhe shoh pas një grua 48 vjeçe, vetëm, me gjashtë fëmijë, në një vend të ri. Kishim qenë në Kanada vetëm katër vjet. E dini? Dhe ajo na mbajti të bashkuar. E ruajti idenë që ne i përkisnim njëri-tjetrit. Na forcoi në dashurinë për njëri-tjetrin.

Anna Di Lellio: Në rregull, por ishim në Australi, tani jemi në Kanada. Jemi në Kanada. Si shkuat në Kanada? Pse shkuat në Kanada?

Kimete Mitrovica Basha: Po, kjo është një tjetër histori zhgënjimi, në fakt. Në vitin 1967 ose '68, babai im u ftua të shkonte në Shtetet e Bashkuara nga organizata VATRA.² Dhe ai u kthye në Australi me këtë ftesë që do të vinte. Të gjithë do të shkonim në Boston, dhe ai do të merrte përsipër botimin e gazetës Dielli,³ e cila ishte themeluar nga Fan Noli, që kishte këtë lidhje familjare. Pra u vendos që do të shkonim atje. Diçka ndodhi. Nuk e kam kuptuar kurrë çfarë. Por papritur nuk po shkonim në Boston. Po shkonim në Toronto. Kështu, shkuam në Toronto. Nuk kishte punë në VATRA. Nuk kishte asgjë.

Ky është një kapitull për të cilin në fakt... po filloj të bëj disa kërkime, sepse po shikoj njerëzit që ishin atje në vitet '60, dhe kishte vdekjen e një burri, Sheiko, i cili ishte një nga drejtuesit e VATRA-s. Mendoj se ndoshta... kjo mbetet ende për t'u zbardhur se çfarë ndodhi. Por ne jemi në Kanada. Na morën nga shtëpia jonë, sido që të ishte, shtatë fëmijë, dhe mbërrijmë, dhe tani, asgjë.

Pra, po. Kjo ishte 1969, 1970, dhe prindërit e mi tani duhet të fillonin të kërkonin punë. Nëna ime gjeti një punë si asistente infermiere në Toronto General Hospital. Ne u integruam në sistemin shkollor. Motra ime e madhe, e cila ishte një grua brilante, dhe ende është një grua shumë brilante, nuk e vazhdoi arsimin universitar sepse papritur kishim nevojë për dikë. Nuk kishte asgjë.

² VATRA (Federata Pan-Shqiptare e Amerikës) është një organizatë historike jofitimprurëse e themeluar në vitin 1912, me seli në Bronx, Nju Jork.

³ Oldest newspaper in Albanian language still in operation.

Ekonomikisht, gjërat u përkeqësuan. Pastaj babai im gjeti një punë. Nuk e mbaj mend vërtet se cila ishte e para, por mendoj se ishte kuzhinier në një fabrikë birre apo diçka e tillë. Dhe motra ime po ashtu punonte me... nuk e mbaj mend çfarë bënte. Duhet ta pyes, por ka kaluar shumë kohë. Gjithsesi, të tre po punonin. Unë e përfundova shkollën e mesme atje. Bëra vitin tim të fundit të shkollës së mesme atje dhe pastaj shkova në universitet. Motra ime u martua. Një vit më vonë ishte e martuar, dy vjet më vonë.

Nuk ishte një kohë e lumtur. Ishte një kohë shumë e vështirë. Dhe pastaj më e keqja, babai im diagnostikohet me kancer, dhe gjithçka del jashtë kontrollit. Vërtet del jashtë kontrollit. Dhe përmes gjithë kësaj, ne disi e përballuam, dhe e kthyem diçka shumë të vështirë në diçka të mirë sepse jemi vërtet një familje e mirë dhe e duam shumë njëri-tjetrin. Dhe mora përgjegjësi. Duhet t'i jap vetes meritë.

Isha në vitet e mia universitare. Punova me kohë të plotë dhe mbajta një pozicion me kohë të plotë në universitet. Nuk ruajta notat e shkëlqyera të klasës së parë, por mora diplomat e mia. Dhe gjithashtu pata dy profesorë që ishin vërtet mbështetësit e mi më të mëdhenj, e dini. Njëri prej tyre ka ndërruar jetë. Me tjetrin vazhdoj të jem mike edhe sot.

Dhe ata më ndihmuan ta kaloj atë periudhë të vështirë në vitet e fundit të universitetit sepse, e dini, babai im po vdiste, dhe unë kalova më shumë kohë në spital sesa në klasë. Por, po, shkuam në Kanada në vitin 1970. Në vitin 1974, ai kishte vdekur, dhe nëna ime ishte vetëm. Dhe ishim në një situatë ekonomike shumë, shumë, shumë të vështirë.

Anna Di Lellio: Gjyshi juaj kishte ndërruar jetë?

Kimete Mitrovica Basha: Gjyshi im ndërroi jetë pas babait tim – gjyshi im, babai i nënës sime. Unë isha e martuar dhe kisha fëmijë.

Anna Di Lellio: Pra ai ishte atje me ju në Kanada?

Kimete Mitrovica Basha: Jo, jo, jo. Ai ishte në Australi. Ne erdhëm në Kanada vetëm. Ishim vetëm nëna ime, babai im dhe ne të shtatë.

Anna Di Lellio: A ishin edhe ata nga Kosova?

Kimete Mitrovica Basha: Gjyshi im, jo. Gjyshi i nënës sime... nëna ime ishte nga jugu i thellë i Shqipërisë, nga Skrapari. Pra kishim, e dini, veriun, veriun shumë të largët, pranë kufirit serb, dhe jugun pranë kufirit grek. Gjithmonë thoshim se ishim mishërimi i idealit etnik shqiptar, e dini. (qesh) Dy skajet, e dini.

Anna Di Lellio: Tani pyetja është, çfarë lloj shqipeje flisni, gegnisht apo toskërisht?

Kimete Mitrovica Basha: Kur u martova, flisja kryesisht toskërisht. Me gabime. Por me kalimin e viteve, ka evoluar, dhe tani është diçka tjetër. Pastaj ka evoluar sërish. Sepse, e dini, kur u martova, Ydrizi ishte padyshim nga veriu. Flisnim me një tonalitet shumë të fortë gegë, intonacion, fjalor, strukturë gramatikore (buzëqesh).

Kështu që e përfshiva atë në mënyrën time të të folurit, sepse ishte lokale dhe të ndikon, apo jo? Pastaj, sigurisht, Shqipëria hapet dhe takon intelektualë, poetë, gazetarë, arkeologë, politikanë, të gjithë të arsimuar në shqipen letrare. Dhe bën përpjekje për të komunikuar (qesh). E dini, mbaj mend herën e parë që shkuam në shtëpinë e Ismail Kadaresë, vajza e tij ishte shumë e vogël atëherë, dhe ai, Ydrizi dhe unë po flisnim me Ismailin, dhe ajo ndërhyr e thotë: “Këta çfarë janë, kosovarë?” – e dini, me theks.

Kështu që, ngadalë, ka evoluar sërish në diçka tjetër. Mendoj se shqipja ime tani është më e pasur, kjo është e sigurt. Nga ana e fjalorit, është shumë më e pasur. Por mendoj se ajo që ndodh është se kur jam me njerëz... unë përshtatem. Përshtatem sipas situatës. Të dielën festuam 40-vjetorin e programit tonë radiofonik, *Jehona Shqipes*. Isha një nga anëtarët themelues, e vetmja grua. Dhe, sigurisht, isha atje. Dhe përgatita diçka sepse isha emocionale për këtë. E dija që do të isha, sepse shumë pak nga ekipi origjinal janë ende gjallë. Dhe kështu kishte shumë nostalgji, si dhe krenari që po ndjeja, por shumë nostalgji, përfshirë edhe për burrin tim. Ai ishte editorialisti i parë, dhe nuk ishte aty.

Dhe mendova të bëja një editorial, e dini. Por e bëra në shqipen letrare sepse kjo ishte diçka që mendoja se do të ishte pothuajse historike, kështu që duhej të flitej mirë. Pra unë zgjedh, e dini. Por mund ta bëj (buzëqesh). Kjo ju tregon sa është përmirësuar shqipja ime, e dini. Po.

Pjesa e Tretë

Kimete Mitrovica Basha: Mund të flas për këtë... Ka aq shumë për të treguar... nuk shkon vërtet vetëm në një drejtim...

Anna Di Lellio: Po, sigurisht, po më tregoje që nëna jote ka jetuar për një kohë të gjatë në Greqi.

Kimete Mitrovica Basha: Po, ashtu është.

Anna Di Lellio: Si ndodhi kjo?

Kimete Mitrovica Basha: Gjyshi im, Sadik Mulla, ishte një lloj biznesmeni, jetonte në Greqi dhe ata punonin atje. Dhe Greqia është aq afër kufirit, kur e mendon! Ata jetuan në Selanik për 17 vjet, por nëse e pyesje nënën time për këtë, ajo nuk jepte hollësi. “Është e kaluara,” thoshte, “është e kaluara.” Por ajo fliste greqisht bukur. Në fakt, kisha miq grekë në universitet, kur isha në universitet, madje një nga miqtë e mi ishte George Papandreu, djali i Papandreut, i cili më pas u kthye në Greqi, por George dhe nëna ime flisnin greqisht dhe ai thoshte sa bukur e fliste ajo; ajo fliste italisht, gjermanisht

rrjedhshëm. Nëna ime fliste... ajo ishte shumëgjuhëshe, dhe ishte një grua jashtëzakonisht inteligjente gjithashtu, analitike për gjërat, por, e dini, ajo... po, ajo jetoi në Greqi.

Ajo... kishte një dashuri të madhe për gjërat greke, por definitivisht nuk ishte greke. Në fakt, patëm vizitën e motrës së babait tim, Kimetes; në vitin '72, mendoj se ishte. Kjo ishte një katastrofë për shumë arsye, por gabimi i saj më i madh ishte t'i thoshte nënës sime se... se ajo ishte greke. Ishte sikur... sikur nuk e dinte që sapo e kishte kryqëzuar veten, e dini? (qesh) Dhe nëna ime tha, "Greke? Kush të tha që jam greke?" e dini? "Unë jam shqiptare!" Dhe kështu, por ajo kishte një dashuri të madhe, ajo... ishte e përshkuar me disa nga ritualet e jetës greke.

Si për shembull, e mbaj mend në Pashkë, ajo ishte nga sekti bektashi, apo jo, një sekt shumë liberal mysliman. Por në Pashkë ne festonim Pashkët me vezë të kuqe e gjëra të tilla. Dhe ndonjëherë ndizte qirinj e gjëra të tilla. Ajo ishte... mendoj se nëna ime ishte thellësisht shpirtërore në disa mënyra. Ajo besonte në engjëj... Besonte në... është shumë interesante, ajo kishte një lloj nevoje për diçka më shumë, e dini. Dhe mendoj se e kishte gjetur këtë, ndoshta, në këtë botë ritualesh që e kishte sjellë me vete nga Greqia.

Për ne ishte shumë e huaj. E shikonim me njëfarë habie dhe, e dini, i donim vezët, por nuk i kuptonim qirinjtë, e dini (qesh). Por e lëmë, e dini, kjo ishte mënyra e saj për të qenë ajo që ishte. Ne... ne e lejuam. Kjo nuk është shumë e qartë. Ne e respektonim, kjo ishte ajo që ishte. Por na dukej shumë e çuditshme, e dini. Por ajo, nëna ime, tipike për të, nuk i interesonte. Bënte atë që donte, e dini. Gjithsesi, po.

Anna Di Lellio: A keni pasur një edukim fetar?

Kimete Mitrovica Basha: Më falni?

Anna Di Lellio: A keni pasur edukim fetar?

Kimete Mitrovica Basha: Ne patëm pikërisht të njëjtin edukim që unë u kam dhënë vajzave të mia. Mendoj se babai dhe nëna ime, babai im ishte... ata të dy ishin myslimanë, e dini. Por ne... mendoj se ajo në të cilën u edukuam ishte tek vlerat.

Na u mësua... Na u dha, mendoj, një edukim që... që do të na jepte një busull morale. Kishte gjëra që ishin të rëndësishme. Ndershmëria. Oh Zot, ndershmëria dhe përlësia. Këto ishin... nuk e di sa herë babai im thoshte se këto ishin dy parimet që duhet të na udhëhiqnin. Ndershmëria dhe përlësia.

Anna Di Lellio: Por jo domosdoshmërisht të lidhura me Kuranin apo Islamin?

Kimete Mitrovica Basha: Jo, jo, krejtësisht të ndara. Nuk mendoj se ndonjëri prej tyre ishte, e dini, pjesë e ndonjë rendi të organizuar fetar. Por kishim një ndjenjë të thellë.

Na u dha kjo ide, e dini, dua të them, nëse dikush do të vidhte apo diçka e tillë, kjo do të ishte... jo, ishte një busull morale. Ishte ideja që këto janë vlerat sipas të cilave duhet ta jetosh jetën nëse do të jetosh një jetë të mirë. Dhe një jetë e mirë është një jetë morale. Dhe kështu, ata kërkonin... kërkonin ndershmeri. Kërkonin besnikëri. Kërkonin bujari. Ishte shumë e rëndësishme të ndaje. Po, këto ishin gjërat që mendoj se na shënjuan dhe u bënë pjesë e asaj që jemi.

Dhe gjithashtu, dhe u bë një temë në jetën tonë që vinte nga babai im, por mishërohej edhe tek nëna ime, i dobëti, e dini, ata që përjashtohen, ata që kanë nevojë për ndihmë. E dini, prindërit e mi nuk kishin shumë para, por e mbaj mend çdo herë që kishte dikush në vështirësi, nëna ime gjente mënyrë që ne t'i ndihmonim. E dini, duhej të jepje nga vetja.

Kjo ishte... ky ishte edukimi im fetar. Dhe vajzat e mia... Unë kam studiuar me Northrop Frye, i cili ishte ministër i United Church of Canada, por ishte edhe një nga kritikët më të mëdhenj letrarë të shekullit të 20-të. Dhe me të kam studiuar dy lëndë, njëra prej tyre ishte themelet e kulturës perëndimore. Pra, kam studiuar mitologjinë dhe Biblën me të. Dhe kam ndjekur edhe kursin që ai jepte, "Bibla si Letërsi". Dhe nga ato kurse kuptova se si njeriu ka kërkuar kuptim, e dini, modelet, mësimet që përsëriten dhe riinterpretohen nga miti në kontekstin biblik, e kështu me radhë.

Dhe në thelb, kërkimi për kuptim në vetvete është një vlerë. Dhe kështu jam përpjekur... ajo që jam përpjekur të bëj me vajzat e mia ka qenë t'u jap atyre qasje në këto modele. Pra, i kam inkurajuar të njohin historitë biblike, ato ende më pyesin, më thonë, na trego çfarë është çfarë, e dini, na trego historinë, sepse ende nuk janë thelluar në këtë, vajza ime e vogël ndoshta pak më shumë.

Por mitet, e dini, njohja e miteve, kuptimi i asaj që na mësojnë. Pra ishte më shumë përmes një edukimi letrar që po angazhohesha me këtë mësim të njëjtë për, përsëri: Çfarë është një jetë e mirë? Si e përmbush potencialin tënd si qenie njerëzore? Si bëhesh një person moral? Burri im ishte më shumë i ndikuar nga mësimi jezuit, e dini, veprim, shpresë dhe veprim. Por të dy u jepnim atyre idenë se veprimi është i domosdoshëm, e dini, thjesht unë nuk e mendoja si model jezuit, e mendoja si diçka tjetër.

Por në fund të fundit, po mësonim të njëjtat gjëra. Dhe po, nuk kam qenë kurrë anëtare e ndonjë organizate, kurrë anëtare e ndonjë partie politike, megjithëse pikëpamjet e mia janë shumë të forta. Dhe kurrë nuk kam qenë anëtare, nuk shkoj në kishë, kurrë nuk kam qenë pjesë e ndonjë kishe apo ndonjë strukture fetare të organizuar. Thjesht nuk u besoj. Nuk ndjej se mund të përshtatem në to. Sepse gjithçka... thjesht... kam shumë mendime të pavarura për gjërat. Nuk mundem. Nuk mund ta pajtoj veten me përkatësinë ndaj diçkaje kaq të strukturuar.

Anna Di Lellio: Po mendoja të të pyesja, dhe po flisje për edukimin tënd etik. Doja të të pyesja për edukimin tënd intelektual. Fillove pak duke përmendur Northrop Frye. Por a ka diçka tjetër që mund të shtosh për këtë? Cili ishte ndikimi yt më i fortë intelektual në jetën tënde? Natyrisht, ndoshta, e dini, kjo lidhet edhe me daljen jashtë familjes kur shkove në universitet, e dini, me leximin.

Kimete Mitrovica Basha: Mendoj se jam studente e letërsisë, e dini, dhe mendoj se leximi im, edukimi im intelektual... kam studiuar edhe me Bloom, e dini, “The Closing of the American...”

Anna Di Lellio: Harold⁴ Bloom?

Kimete Mitrovica Basha: Harold Bloom. Po, e dini, isha... isha me fat. Mendoj se kam qenë shumë me fat. Kisha profesorë shumë sfidues në universitet. Por edhe babai im, babai im nuk... babai im lexonte, e dini, John Stuart Mill me mua, e dini, sepse nuk e kuptoja. Isha duke lexuar, isha vetëm 16 vjeç, mendoj, dhe duhej të lexoja “On Liberty”, dhe nuk po e kuptoja. Kështu që shkova tek ai dhe i thashë, nuk e kuptoj. Ai tha, lexoje me mua. Dhe ai ma sqaroi, ishte një mësues shumë i mirë, e dini. Nuk e di... intelekti im... thjesht shumë gjëra.

Mendoj se leximi ka qenë gjithmonë diçka që e kam dashur. Dhe kam lexuar gjithçka dhe çfarëdo që kam mundur të gjej. Tani lexoj më pak se më parë, mendoj, për shumë arsye. Por unë... isha e magjepsur nga mitologjia. Kam lexuar shumë gjatë rritjes sime. I dua përrallat. I dua. Po, kam lexuar shumë. Nuk e di.

Është një pyetje e mirë. Mendoj se ngadalë, si fëmijë, mendoj se mitet, kjo botë e mrekullueshme e gjërave të jashtëzakonshme që mund të ndodhin, transformimet, metamorfozat e kështu me radhë. Kjo më dha shumë shpresë, në fakt, sepse, e dini, gjërat mund të ndryshojnë, gjërat mund të bëhen magjike, e dini. Dhe pastaj takimi me Northrop Frye, sfida për të qenë në gjendje të ndiqja disa nga gjërat që...

Anna Di Lellio: Sa me fat je me këta profesorë.

Kimete Mitrovica Basha: Po, është e pabesueshme. Ai ishte... dhe pastaj ajo që ishte interesante për të, ishte kaq i butë. Skuqej. Ishte një njeri kaq i butë. Edhe kjo të mëson diçka për përlësinë dhe për mënyrën se si, e dini, dijenia dhe statusi nuk do të thonë domosdoshmërisht arrogancë e të gjitha këto.

Pra edhe kjo, mësimet e përlësisë. Por mendoj se... duhet të them se... Virginia Woolf ishte një nga ndikimet kryesore për mua. Mendoj se ajo më bëri të mendoj shumë për veten time si grua, për atë që më duhet për të ekzistuar, si të ekzistoj, për betejat e saj, jo vetëm psikologjike, por edhe krijuese, përkushtimin ndaj diçkaje.

Por mendoj se e kam thënë, “A Room of One’s Own”, ajo goditje ishte si një rrufe në jetën time, e dini. Ndjeva sikur po më thoshte diçka për atë që duhej të bëja për të ekzistuar vërtet. Pfuuhh! E dini, nuk kisha jetuar kurrë, askush nuk më kishte dhënë të drejtën për privatësi. E dini, dhe papritur, po e kërkoja atë.

⁴ Keqkuptim. Personi i përmendur nga folësi është Allan Bloom, një filozof dhe studiues amerikan i letërsisë klasike, i njohur më së shumti për librin e tij *The Closing of the American Mind* (1987).

Dhe po kërkoja në mënyrën time gjëra që ndoshta do të ishin të vështira për t'u pajtuar me identitetin tim shqiptar, e dini – si të jem e lirë, si të shprehem. Pra ajo ishte... ishte me ndikim. Por leximi im, letërsia ime ishte, e dini, kam lexuar Platonin dhe po përpiqesha t'i kuptoja të gjitha këto gjëra, e dini, dhe kam lexuar... po përpiqem të mendoj, e dini, kishte aq shumë.

Mbaj mend që lexova “Madame Bovary” dhe u mbingarkova, e dini, nga kjo grua në pakënaqësinë e saj, e dini? Dhe mendova, “pse kaq shumë gra rreth meje janë të pakënaqura?” e dini? Të gjitha këto gjëra po ndodhnin në të njëjtën kohë, kishte një lloj pyetjesh. Dhe pastaj mendoj se... kur u largova nga bota intelektuale, u martova, hyra në botën shqiptare, atëherë e gjitha kjo po vihej në provë. Atëherë mori një kuptim të vërtetë, nuk ishte më vetëm mendim abstrakt për pakënaqësinë, privatësinë, të drejtën për të ekzistuar sipas mënyrës se si ti e përcakton marrëdhënien tënde me të vërtetën.

Dhe mendoj se kur u ktheva në botën shqiptare, e gjitha kjo mori kuptim real. Të gjitha këto gjëra filluan të bëheshin fusha beteje. Dhe unë duhej të qëndroja në këmbë për veten time.

Duhej të luftoja. Dhe kurrë nuk desha ta braktis feminitetin tim, të jem e sinqertë. Doja të mbetesha grua, jo një grua e zemëruar, por një grua, me gjithë forcën që mbetet. Por për t'u përballur me disa nga këto gjëra, nuk ishte gjithmonë e lehtë. Por e bëra. Mendoj se e bëra mjaft mirë.

Dhe kam rritur dy vajza që janë me mendje të pavarur, të forta, me vullnet, dhe bujare. Kam pasur sukses sepse mendoj se u kam modeluar diçka tjetër. Dhe kjo është e rëndësishme për mua. Pra udhëtimi im intelektual filloi me përrallat dhe mitet, dhe përfundoi me... mirë, nuk përfundoi, është një proces i vazhdueshëm, apo jo? Gjithmonë je duke u bërë. Por unë vazhdoj, e dini, tani nuk lexoj aq shumë letërsi artistike. Dikur lexoja shumë. Tani lexoj shumë filozofi, e dini, po lexoj shumë për identitetin tani, shumë për identitetin. Por mendoj se ndoshta jam zgjatur pak në këtë përgjigje, sepse ndoshta ende nuk e kam përpunuar plotësisht vetë.

Anna Di Lellio: Është shumë mirë. Ndonjëherë mendojmë teksa flasim.

Kimete Mitrovica Basha: Po.

Anna Di Lellio: Dhe është shumë interesante, sepse nga ajo që the, si në bisedat e mëparshme, ashtu edhe tani, e përmende që patët një takim me bashkëshortin tënd dhe ishte dashuri, apo jo? Kjo dashuri romantike. Por pastaj flet për të gjitha gjërat që përmende, gjërat që bëtë bashkë. Pra kishte edhe miqësi dhe bashkëpunim. A mund të më tregosh, të na tregosh pak më shumë për këtë? Pse ishe në Nju Jork? Si ndodhi kjo... kur e takove bashkëshortin tënd? Ishe në Toronto, aty e lamë, ishe në Melburn, pastaj në Toronto, tani në Nju Jork.

Kimete Mitrovica Basha: Po, si ndodhi... ishte... e dini, shiko, ndikimi i babait tim në jetën time është vërtet i thellë. Por mendoj se në njëfarë mënyre ai më çoi tek Ydrizi. Pra, babai im vdes në vitin 1974, në nëntor 1974. Unë... kisha filluar të jepja mësim dhe më në fund kisha pak para.

Kështu që vendosa me vëllanë tim, në verën e vitit 1977, që do të bënim diçka argëtuese. Pra, unë dhe vëllai im Dervishi vendosëm të udhëtonim me çanta shpine nëpër Angli, Uells dhe Skoci. U nisëm. Unë e kisha vajtuar babain tim, ende po e vajtoja babain tim. Kisha pasur gjithashtu një marrëdhënie platonike, duhet ta theksoj, por shumë domethënëse, me një nga miqtë e mi në universitet. Dhe ajo nuk kishte funksionuar. Pra, po vajtoja edhe atë. Dhe kështu bëmë këtë udhëtim, me çanta shpine, dhe pastaj u ktheva.

Në gusht të vitit 1977 jam kthyer në Toronto me vëllanë tim. Jam... jam e fortë, jam e shëndetshme, sepse kemi ecur shumë. Dhe ndihesha... në fakt kam shkruar në ditarin tim se po kthehesha si në fund të një filmi të Fellinit, e dini, gjithçka ishte rregulluar, kishte harmoni, e dini (buzëqesh), ndihesha mirë.

Dhe pastaj dëgjoj se do të ketë një mbledhje të Partisë së Legalitetit në Nju Jork në nëntor. Dhe e kuptova se do të ishte e rëndësishme, ndjeva se ishte e rëndësishme që një anëtar i familjes të ishte atje, megjithëse nuk kam asnjë prirje monarkiste, absolutisht asnjë. Por mendova se prania e Mitrovicave duhej të ishte aty. Ia thashë këtë nënës sime dhe ajo nuk ishte shumë e entuziazmuar, sepse e dinte që ishte vërtet një botë burrash. Dhe do të ishin, e dini, 300 burra, dhe çfarë... do të jesh e vetmja grua aty, e dini? Kështu që unë këmbëngula dhe argumentova se kumbari im, djali i Abaz Kupit, Petrit Kupi, do të ishte aty dhe do të isha me të. Dhe më në fund ajo pranoi, disi tha, "Oh, shko!" e dini.

Pra, shkova. Dhe më 27 nëntor 1977, jam ulur me kumbarin tim duke pritur. Kisha mbërritur vetëm 15 minuta më herët sepse nuk doja të dëgjoja të gjitha fjalimet. Dhe pastaj erdhi koha për drekë, u ngritëm. Dhe ky burrë, po e dëgjoja që po fliste frëngjisht, ishte ulur përpara meje duke pirë puro. U ngrit. Dhe kumbari im tha, "Dua t'ju prezantoj." Dhe më prezantoi me Ydriz Bashën. Ydriz Basha më tha, "Oh, më fal," e dini, në një mënyrë shumë qesharake... (qesh) "më fal, unë nuk flas anglisht."

Dhe unë thashë, "Nuk ka problem, flasim shqip." Por thashë, "S'ka problem. Unë flas shqip." (qesh) Ai bëri kështu {imituar sikur u befasua}, e dini, dhe në momentin që më shtrëngoi dorën, nuk mund ta shpjegoj. E dija që ai do të martohej me mua. E dija që unë do të martoheja me të.

Dola nga ajo dhomë me kumbarin tim. Dhe i thashë, "Kush është ai?" Ai tha, "Është mjek. Është mjek." Tha, "Studion në Francë." Ishte krejt gabim. Nuk ishte aspak kështu. Kishte studiuar mjekësi, por ishte psikoanalist dhe ishte në Francë. Telefonoj nënën time. Shkoj në një telefon dhe e telefonoj.

Dhe i them, "Duhet të vish në Nju Jork." Ajo tha, "Pse?" Unë thashë, "Sepse kam takuar burrin me të cilin do të martohej. Por nuk do të martohej me të nëse ti nuk më jep lejen." Dhe ajo tha, "A je çmendur?" Dhe vërtet... absolutisht. Ajo erdhi. Dhe të hënën ai më kërkoi të martoheja me të. Dhe unë pranova.

Pjesa e Katërt

Anna Di Lellio: Mirë, ai e dinte gjithashtu, apo jo? Ti e dije që do të martoheshe me të dhe ai e dinte gjithashtu.

Kimete Mitrovica Basha: Po, po, po, sepse sigurisht ishte koha e drekës dhe ai kishte shkuar për drekë me Selim Damanin, i cili ishte ish-gjyqtar, bashkëshorti i motrës së Eqrem Çabejt. Dhe Selim Damani ishte mik shumë i mirë i tij dhe më vonë do të bëhej dëshmitar në dasmën tonë.

Dhe ai tha, “Kush është ajo vajzë?” Dhe Selim Damani tha, “Oh, ajo është e jona,” sepse Selim Damani dhe gjyshi im ishin shumë të afërt. Dhe Rexhep Kasniqi, i cili ishte gjithashtu pjesë e Lëvizjes [Legaliteti]... gjithsesi, ishte gjithashtu i afërt me familjen tonë, ata ishin të gjithë aty dhe po bisedonin dhe po thoshin, “Jo, jo, ajo është e jona, është e jona, e dini. Do ta rregullojmë ne këtë për ty,” këtë lloj gjëje. Pra, dy ditë më vonë ata organizuan që të hanim darkë bashkë dhe ai më kërkoi të martohesha me të, të paktën me nënën time aty.

Ai kërkoi. Fillimisht foli me nënën time. Është e bukur gjithashtu, e dini, aty luan pak lojën, sepse ai ishte... pra, të shtunën, të dielën, kishim aktivitete, e kisha parë. Dhe është ende një moment i bukur romantik, sepse është kaq shqiptar, në fakt.

Ai... unë isha në holl, ai doli nga salla. Më pa dhe unë isha në telefon me motrën time. Ai u drejtua nga unë. Dhe unë i thashë motrës, “O Zot, po vjen drejt meje.” Dhe ajo tha, “Kthehu, kthehu nga ai. A ka njeri në holl që do t’ju shohë nëse ai flet me ty?” Dhe ai erdhi tek unë dhe unë thjesht fola me të (qesh), e dini, dhe ai më tha, “A ke qenë ndonjëherë në Evropë?” Dhe unë thashë, “Jo, kam qenë në Angli.”

Dhe ai tha, “Duhet të vish në Evropë.” (qesh) Gjëra të vogla budallaqe si kjo. Por papritur... nuk e di, ishin gjëra të vogla të bukura, të ngarkuara me këtë ndjenjë dhe përmbajtje dhe të gjitha ato që i bëjnë ato momente momentet më romantike të jetës sate, e dini.

Gjithsesi, ai më kërkoi të martohesha me të, dhe unë u martova me të. Nuk u pamë. Domethënë, u fejuam, por nuk u pamë për gati tetë muaj, nëntë muaj. Por filluam t’i shkruanim njëri-tjetrit. Dhe filluam të shkruanim vetëm pasi u sqarua keqkuptimi. Sepse ai... kunati im i kishte thënë, kur ai kishte kërkuar adresën time – unë nuk mendova t’ia kërkoja të tijën – ai, kunati im, refuzoi t’i jepte adresën time. Kështu kaluan muaj para se të dëgjoja prej tij. Kishte njëfarë shqetësimi nga ana e nënës sime se kjo disi... sepse nëna ime ishte nëna ime, disi do të përfundonte në katastrofë (qesh). Dhe unë do të turpëroheshja e të gjitha këto. Kështu që telefonova një burrë për të cilin kisha shumë respekt, të cilit babai im i kishte kërkuar të kujdesej për ne kur po vdiste. Ai njihje Ibrahim Kulën, i cili... kishte restorante në Peterborough, Ontario, një burrë i mirë.

Dhe Ibrahim fluturoi për në Evropë për të kuptuar se çfarë po ndodhte. Dhe gjëja tjetër që di, marr një telefonatë nga Ydrizi ndërsa Ibrahim ishte me të, duke shpjeguar se, “Kimete, më thanë të mos të kontaktoja.” Dhe kështu... dhe mendoj se atë ditë e kuptova se isha në një kontekst ku mendoja se bëhej fjalë për Ydrizin dhe mua. Por kisha hyrë në një kontekst ku papritur njerëzit, përfshirë edhe pala e Ydrizit, mendonin se kishin autoritet mbi mua dhe do të diktonin se si do të zhvilloheshin këto gjëra

dhe si do të ecnin përpara, se burrat do ta vendosnin këtë. Sigurisht që po më mbronin, por në fakt po afirmonin pushtetin e tyre.

Dhe kështu, unë dhe Ydrizi duhej ta zgjidhnim këtë. Dhe e zgjidhëm. I shkruanim njëri-tjetrit çdo ditë. Dhe një herë në javë i shkruanim një letër shumë të gjatë njëri-tjetrit. (qan)

Anna Di Lellio: Këto janë kujtime të bukura, shumë të bukura.

Kimete Mitrovica Basha: Po. Mendoj se unë dhe Ydrizi ia zbuluam veten njëri-tjetrit përmes atyre letrave. Dhe e kuptova se Ydrizi e shihte këtë bashkim jo vetëm si martesë mes një burri dhe një gruaje, por si përgatitje për shërbim. Ai kishte identifikuar tek unë diçka që unë vetë nuk e dija, që isha e aftë të merrja një rol publik dhe që atij i duhej dikush për ta bërë këtë bashkë.

Ai aspironte të bëhej një lider i komunitetit shqiptar, por ishte tashmë 40 vjeç dhe askush nuk e merrte seriozisht sepse në patriarkat një beqar është po aq i rrezikshëm sa një grua 20-vjeçare e pamartuar, apo jo? Nuk ka vend në shoqëri. Duhet të jesh i martuar për të qenë burrë. Dhe kështu, ai duhej të martohej dhe gjeti partneren e tij, dhe ne patëm një partneritet. Si çdo martesë, patëm ngritjet dhe uljet tona, patëm fushat tona të betejës, patëm gjëra për t'i zgjidhur, por kishim një aftësi të jashtëzakonshme për t'i thënë të vërtetën njëri-tjetrit. Dhe nuk e di pse nuk kam pasur kurrë frikë nga kjo.

Pra ndërtuam një partneritet dhe ai partneritet ishte i drejtuar jo vetëm për të rritur dy fëmijët tanë në një kontekst harmonie, jo, Ydrizi kishte një aftësi për të ëndërruar që unë e mësova prej tij. T'i realizonte ato ëndrra, t'i bënte realitet, ishte diçka e jashtëzakonshme. Ai burrë kishte fuqinë t'i bënte ëndrrat realitet. Por i duhesha unë që t'i bënte realitet. Dhe punuam bashkë. Punonim shumë mirë bashkë.

Kështu që kur filluam në vitet '70 shumë shpejt të organizonim aktivitete në komunitetin shqiptar, sigurisht që '81-ta në Prishtinë, demonstratat, e fokusuan punën tonë dhe filluam të punonim me Enver Hadrin dhe të tjerë për të...

Anna Di Lellio: Jetonit në Bruksel?

Kimete Mitrovica Basha: Po, në Bruksel, për të organizuar demonstrata, por edhe për ta ndërkombëtarizuar çështjen, duke e bazuar shumë punën tonë në detyrimet e Jugosllavisë sipas marrëveshjeve për të drejtat e njeriut, që, e dini, Parlamenti i Helsinkit, Parlamenti Evropian ishin krijuar, dhe ta përdornim këtë si forcë. Pra, siç thashë më herët, kishim një qasje me tre shtylla: pedagogjike, informuese, por edhe për të ndikuar në politika.

Pra organizonim aktivitetet tona, punonim shumë, shumë fort. Dhe ai pa që unë isha e aftë ta ndihmoja dhe nuk kisha komplekse në publik. Ka një rast shumë qesharak kur po organizonim këtu diskutime në Bruksel për situatën në Kosovë. Kishte shpesh, por ishte një takim i nivelit të lartë dhe ata

më kishin kërkuar të përktheja një letër nga anglishtja në shqip dhe pastaj ta lexoja letrën në anglisht në demonstratë. Nuk e kuptoja pse duhej ta bëja këtë.

Pra jemi përpara qindra shqiptarëve që valëvitnin flamujt dhe thërrisnin për liri, dhe unë dal te mikrofoni, me të gjithë burrat pas meje, folësit, dhe u thashë turmës: “Duhet ta lexoj këtë letër në anglisht. A doni ta lexoj në anglisht?” Të gjithë filluan të qeshnin. Pastaj thashë: “Sa prej jush flisni anglisht?” Dhe ata qeshnin. Pastaj thashë: “Nuk do ta lexoj këtë letër. Letrën mund ta merrni dhe ta ndani. Ja çfarë do t’ju them.”

Dhe ende e mbaj mend. U përfshiva nga emocioni. Thashë: “Po takohemi vazhdimisht. Jemi takuar në rrugët e Bonit. Jemi takuar në rrugët e Frankfurtit. Jemi takuar në rrugët e Parisit. Tani jemi në rrugët e Brukselit. Një ditë do të jemi në rrugët e Prishtinës duke ecur si burra dhe gra të lirë.” Dhe e bëra me ta. Dhe të gjithë brohorisnin.

Dhe Ydrizi erdhi te mikrofoni dhe tha: “Tani ma vrave fjalimin.” Ai e shijonte këtë, nuk ndihej i kërcënuar. Më lejoi të shpreheshja dhe të bëhesha potenciali i plotë që kisha brenda. Sepse në këtë botë mizogjene ku isha, po të mos më kishte mbështetur ai, do të isha shtypur.

Anna Di Lellio: Ke pasur probleme me të tjerët?

Kimete Mitrovica Basha: Oh, shumë. Po. U përpoqën të më ndalonin, të thoshin... po, kur fillova të punoja, më thanë gjithçka përveçse “kurvë”. “Ne nuk i dërgojmë gratë tona të punojnë.” Dhe në universitet, nuk do të rrija në shtëpi, e të bëja çfarë?

Anna Di Lellio: Çfarë po bëja?

Kimete Mitrovica Basha: Po jepja mësim në International School of Brussels. Ishte puna ime e parë. Shkova në mëngjes për të kërkuar punë dhe u ktheva në mbrëmje me një punë. Të gjithë thoshin se nuk do ta gjeja kurrë, por e gjeta. Ishte një punë e mrekullueshme. Na ndihmoi shumë si familje, sepse më dha liri. Më dha një komunitet rreth meje që mbështeste punën tonë. Më dha qasje te elita në Belgjikë. Hapi dyer që ndoshta do të kishin qenë më të vështira pa ato lidhje. Fitova respektin e njerëzve në shkollë, profesionalisht dhe personalisht.

Për shembull, kur shkuam në Shqipëri në vitin 1991, e gjithë shkolla e festoi. Kur filluam të mbështesnim shkolla në Kosovë dhe Shqipëri, komuniteti erdhi dhe na mbështeti bujarisht. Pra nuk ishte vetëm burim i jetës sime profesionale dhe stabilitetit financiar, por edhe një platformë për të ndihmuar çështjen tonë. Po, hasa shumë pengesa, kujtesa e vazhdueshme se isha vetëm një grua, kufijtë që ata mendonin se më përcaktonin. Por nuk e ndryshova sjelljen time. U sigurova që të ekzistojta ashtu siç doja, edhe pse nuk ishte e lehtë.

Pra, po punoje, po rrisje fëmijët. Po. Dhe po organizoje, po lobonit, po avokonit. Po, i bëra të gjitha. Dhe e bëra me energji. Nganjëherë isha e lodhur, por jo vërtet. Po, i bëra të gjitha. Në një moment, Ydrizi punonte më pak, sepse pas vitit 1990 ishte më shumë Shqipëria dhe Kosova sesa psikoanaliza.

Financiarisht u bë një barrë që e mbajta kryesisht unë. Por kishim shlyer apartamentin, kështu që ishte më e lehtë, megjithëse jo gjithmonë.

Bëj shaka që pasi Ydrizi vdiq dhe e shita apartamentin – vajzat e mia ishin larguar, njëra në Angli, tjetra në Portugali – kisha një apartament të madh që më kushtonte më shumë sesa më jepte. Një vit pas vdekjes së tij vendosa ta shisja. Dhe vendosa të vazhdoja të jetoja, por ndryshe.

Por për ta bërë këtë, më duhej ta shisja apartamentin, sepse më duhej stabilitet financiar. Kështu që e shita. Dhe bëj shaka për këtë: ishte hera e parë në jetën time që nuk duhej të shqetësohesha në fund të muajit. Që më në fund mund të ndihesha e lirë. Nuk kisha më lidhje emocionale të atij lloji, nuk e fajësoja veten që doja të jetoja ndryshe. Isha e ve.

Dhe mendoj se e kam nderuar burrin tim që kur ka ndërruar jetë. Kam punuar shumë, shumë fort për të mbrojtur trashëgiminë e tij dhe për të nderuar partneritetin tonë, sepse edhe unë ekzistoj në atë histori. Por nuk do të jem e burgosur e pikëllimit. Dhe nuk do të jem e burgosur e pritshmërive të njerëzve për vejushën shqiptare. Nuk do ta bëj.

Anna Di Lellio: Dhe sigurisht jo e burgosur e një apartamenti, duke qenë se ke udhëtuar gjithë jetën dhe je zhvendosur vazhdimisht.

Kimete Mitrovica Basha: Po, është një gjë, apo jo? Është thjesht një gjë. Kjo është gjithashtu diçka që mendoj se është thelbësore tek unë. Nganjëherë fëmijët e mi nuk e kuptojnë. Por unë kurrë nuk kam pasur asgjë timen. Asgjë nuk ishte e imja si fëmijë. Asgjë. Dhe kështu, nuk lidhem shumë me gjërat. Kam krijuar një ambient që mendoj se më pasqyron. Ndihem rehat, mendoj se është mikpritës dhe ka bukuri këtu. Por nuk më interesojnë shumë gjërat. Vërtet nuk më interesojnë.

Është paksa e vështirë. Të vetmet gjëra që nuk i jap janë dhuratat që më kanë bërë të tjerët. Dhuratat i respektoj. Por është shaka: vajza ime thotë, mos i thuaj që të pëlqen, sepse ta jep. Sepse nëse do të më thoshe, oh, sa e bukur kjo, do të thosha, a e do? Unë nuk zotëroj gjëra. Është qesharake, ndihem sikur jam thjesht kujdestare e gjërave. Mos më trego, sepse ka disa gjëra që i dua. Jo, jam kujdestare, sepse kjo vjen nga mënyra si jam rritur.

Anna Di Lellio: Dëgjo, dua të të pyes, sepse po flisje për të gjitha këto aktivitete, si e përjetove luftën? Kur filloi lufta? Si e përjetove atë periudhë? Si e përjetove? Sepse ishte larg, nuk e di nëse kishe të afërm atje?

Kimete Mitrovica Basha: Jo, nuk kam të afërm që i di. Epo, Ydrizi ishte në ambasadë atëherë. Ai përfaqësonte Shqipërinë. Ishte ambasador i Shqipërisë gjatë luftës. Dhe kjo krijoi një konflikt, sepse Ministri i Jashtëm, Paskal Milo, ishte i përqendruar kryesisht në krijimin e besueshmërisë për Partinë Socialiste të Shqipërisë në Evropë. Prioriteti i tij nuk ishte Kosova.

Dhe Ydrizi ndjente se qeveria shqiptare duhej ta bënte prioritet. Ai mendonte se ishte një tradhti historike, që kishte ndodhur më parë nën Enver Hoxhën dhe po ndodhte sërish. Dhe mendoj se,

gabimisht, ai kishte supozuar se si ambasador do të kishte më shumë liri për ta mbrojtur çështjen e Kosovës. Në fakt, ai e kuptoi se ambasada krijonte barriera për lirinë e të folurit. Kështu që filloi të shkruante dhe të botonte në nivel personal. Siç thashë, jo si ambasador, por si Ydriz Basha.

Kjo krijoi gjithnjë e më shumë konflikt me qeverinë dhe përfundimisht çoi në vendimin tonë për t'u larguar nga ambasada, gjë që ata në mënyrë shumë cinike as nuk e pranuan zyrtarisht. Pastaj dërguan një faks, të panëshkruar, për të thënë se ishte shkarkuar. Ishte një kohë e tmerrshme. Pandershmeri, politikë e vogël.

Por si e përjetova atë periudhë? Me shumë vuajtje. E ndjeva thellë. Punova. Një nga përparësitë e të qenit gruaja e ambasadorit në atë kohë ishte se më dha qasje te Kryqi i Kuq, Médecins Sans Frontières. Punova me të gjitha këto organizata për të bërë diçka, për të ndihmuar. Nuk mund të ndihmoja drejtpërdrejt në Kosovë, por mund të bëja diçka për njerëzit që po vërshonin në Belgjikë dhe Francë. Kështu që punova me këto organizata. U përpoqa të organizoja aktivitete për gratë në kampet e refugjatëve. Bëmë, e di që tingëllon si gjë e vogël, por ishte një ditë gëzimi në mes të vuajtjes. Organizuan për fëmijët, më fal (qan).

Pjesa e Pestë

Kimete Mitrovica Basha: Ishte një kohë shumë e vështirë dhe, siç po thosha, organizuam, mobilizuam shkollat evropiane dhe shkollat ndërkombëtare këtu, dhe krijuam një lloj turneu futbollit. Pra u siguroam fëmijëve bluza me shqiponjën, siguroam topat e futbollit dhe organizuam ndeshje që fëmijët të përgatiteshin për të luajtur, në vend që të rrinin ulur pa bërë asgjë. Dhe këta fëmijë... nuk po them të mjerë, por kishin kaluar trauma, ishin në një vend të huaj, nuk e dinin sa kohë do të qëndronin aty, nuk e dinin çfarë do të ndodhte, kështu që kjo u jepte diçka për t'u marrë, për të kaluar kohën.

Krijuam një bibliotekë. Bëmë shumë gjëra të vogla për të përmirësuar cilësinë e kohës që po kalonin aty. Është diçka, të paktën. Nuk ndryshoi rrënjësisht asgjë, por ndjeja se u tregonte atyre që ekzistonin, që na interesonin dhe që na interesonte ajo që po u ndodhte.

Takova disa nga gratë dhe e shihje që ishin të traumatizuara, dhe ti shkon aty si gruaja e ambasadorit nga bota jote e rehatshme – ishte përlënë, thellësisht përlënë. Dhe gjithashtu, mendoj se ishte një nxitje për të bërë më shumë.

Një tjetër gjë që sugjerova, sepse punoja me ministrin, mendoj se ishte ministri i bashkëpunimit – e kam harruar emrin – i thashë: “Duhet t'i regjistrojmë emrat e të gjithëve, duhet të mbajmë shënime këta njerëz, nga kanë ardhur, sepse në një moment do të duan të dinë çfarë ka ndodhur me familjet e tyre. Dhe duhet ta bëjmë këtë në çdo kamp.” Nuk e di nëse e bënë apo jo. Thjesht mendoja se ishte e rëndësishme të regjistronim gjërat, t'i dokumentonim – kjo ishte pjesërisht bibliotekarja brenda meje.

Duhej të kishim dokumente historike të kësaj përvoje. Dhe duhej ta ndanim me të tjerët. Sepse këta njerëz ishin të humbur në atë moment. Jetonin me pasiguri, frikë dhe traumë. Por kjo nuk do të zgjaste përgjithmonë, kjo do të përfundonte. Dhe kur të përfundonte, duhej të ishim në gjendje t'i lidhim njerëzit sërish, t'i ndihmonim të gjenin njëri-tjetrin përsëri.

Pra, kjo ishte diçka për të cilën punova shumë fort. Ishte. Por në një farë mënyre ishte edhe një ndjenjë pafuqie. Bën këto gjëra të vogla dhe mendon se po bën diçka, por nuk mund ta ndryshosh atë që po ndodh. Dhe sheh këtë lumë njerëzish. Dhe lexon për atë që ndodh në kufi me Maqedoninë. Dhe e kupton që tmerret po përsëriten.

Dhe e di çfarë po u ndodhte grave në Kosovë, e di... dhe mendon se kjo është vetëm fillimi, nuk është fundi (buzëqesh). Dhe si do të jemi pjesë e shërimit? Si do të jemi pjesë e së ardhmes? Ishte një periudhë jashtëzakonisht e trazuar emocionalisht për mua. Por unë kam këtë... e quaj veten rezistente. Dhe nuk...

Edhe vajzat e mia e kanë këtë. Ne kërkojmë zgjidhje. Mund të rrih e të ankohesh, të vajtosh situatën tënde. Ose mund të thuash: “Mirë, si do ta bëjmë këtë më mirë?” ose “Si mund të kontribuoj në mënyrë pozitive?” Të marrësh nga ajo përvojë diçka që mund ta kthesh në diçka të mirë. Dhe nga vuajtja e popullit të Kosovës në atë kohë, e vetmja gjë që mora me vete ishte se kishte ende qëllim, kishte ende shumë punë për t'u bërë. Dhe duhej të gjeja një mënyrë për të vazhduar të kontribuoj.

Sepse Bernardi,⁵ personi me të cilin shkrova librin *Drejt Dritës: Një bisedë me Kimete Mitrovicën*, thotë shpesh: “Duhet të jesh krenare për veten.” Nuk mendoj kështu. Po, jam krenare për veten, por nuk ulesh e thua: “E bëra atë në 1981.” Jo. Duhet të vazhdosh të mendosh se si mund të kontribuosh më tej. Dhe për mua tani bëhet fjalë për...

Këta njerëz e kaluan atë luftë. Tani janë kthyer, jo të gjithë, por shumica, dhe po përpiqen të ndërtojnë institucione dhe demokraci. Roli im tani është të kuptoj se ku kanë nevojë për mua. Dhe kam zgjedhur, në mënyrë modeste, të ndihmoj Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Sepse mendoj se është një institucion që mbron dijen, ka misionin të mbledhë njerëzit rreth një ideje. Dhe kjo është e rëndësishme.

Anna Di Lellio: Dhe në çfarë mënyre po e ndihmon Bibliotekën Kombëtare?

Kimete Mitrovica Basha: Së pari, u kam dhënë të gjitha arkivat e familjes sime. I kam dorëzuar në formë digjitale. Mund t'jua tregoj, i kam digjitalizuar të gjitha dokumentet tona. Nuk i kam përfunduar ende plotësisht. Kam ende disa kaseta video dhe materiale të tjera për t'i përpunuar. Por gjithë dokumentacioni në letër është digjitalizuar. Dhe këtë ua kam dhënë tashmë në formë digjitale.

⁵ Bernard Nikaj është ligjërues në universitetin RIT Kosovo. Më parë, ai ka shërbyer si Ambasador i Kosovës në Belgjikë dhe Luksemburg, si dhe si Shef i Misionit të Kosovës pranë Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Ai ka qenë gjithashtu Ministër i Tregtisë dhe Industrisë në Qeverinë e Kosovës.

E kam organizuar si një databazë të kërkueshme. Ua kam dorëzuar dhe do të bëjnë çfarë të duan me të. Por është në dispozicion. Dhe një ditë shpresoj të jap më shumë informacion për atë që po ndodhte këtu në Bruksel gjatë viteve '70, '80 dhe '90, ndërkohë që në Kosovë ndodhnin ato që ndodhnin. Sepse për mua mesazhi është mesazh shprese.

Dhe gjithashtu është mesazh njohjeje se, edhe pse ata nuk e dinin atëherë, nuk ishin të harruar. Zëri i tyre dëgjohej në Bruksel dhe Paris. Ne po flisnim për ta. Po i mbronim. Vuajtja e tyre nuk ndodhte në izolim, edhe pse ata nuk e dinin. Dua që kjo të dëgjohet.

Por gjithashtu mendoj se ajo që dua të bëj tani është... Drejtoresha e re e Bibliotekës Kombëtare do të vijë në Bruksel. Kam organizuar që ajo të takohet me drejtorin e Bibliotekës Kombëtare këtu. Shpresoj që kjo të jetë një marrëveshje dypalëshe. Sepse mendoj se Biblioteka Kombëtare dhe kjo këtu janë të barabarta, dy drejtorë të dy institucioneve kombëtare. Zonja Rogova nuk po vjen për të kërkuar diçka. Po vjen për të ndërtuar një marrëdhënie, për të ndërtuar diçka së bashku.

Pra po përpiqem, e kam organizuar edhe këtë. Shpresoj që kjo të ndërtojë më shumë lidhje për bibliotekën në sferën evropiane dhe, shpresoj, ta ndihmojë në mënyrën që ata vetë do ta përcaktojnë, të përmirësojë shërbimet, ndoshta programet e shtrirjes. Kjo u takon atyre ta zhvillojnë.

Por unë jam mbështetëse e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës. Dhe do të bëj çfarë të mundem për t'i ndihmuar të vazhdojnë të ndërtojnë një vizion që do ta bëjë të vlerësuar edhe në Kosovë, sepse kam ndjesinë se njerëzit nuk e kuptojnë plotësisht rolin e saj, apo nuk e vlerësojnë sa duhet. Pra edhe pak PR për bibliotekën, e dini. Kjo është një nga gjërat.

Anna Di Lellio: Më duket shumë e rëndësishme materiali arkivor që po jepni, ndoshta sepse unë jam më e vetëdijshme për atë që ndodhi në Shtetet e Bashkuara dhe në Evropë në vitet '70 dhe '80. Por padyshim që ju ishit këtu me Ydrizin, me Enver Hadrin dhe të tjerë, duke bërë gjithë atë punë. Dhe është e rëndësishme të kuptohet. Dje, duke folur me Teutën, ajo po më tregonte se kur u vra Enver Hadri, kishte një ndjesi... një traumë për këtë komunitet. Më vjen keq që po rikthej një kujtim të dhimbshëm, por a mund të na tregoni çfarë ndodhi? Sepse një figurë shumë e pranishme në udhëheqje u eliminua. Duhet të ketë qenë edhe shqetësuese për ju, sepse e kuptonit...

Kimete Mitrovica Basha: O Zot!

Anna Di Lellio: ...frikën se diçka mund të ndodhte. A mund të na tregoni më shumë?

Kimete Mitrovica Basha: Mund të tregoj shumë për këtë. Sepse gjatë viteve '80, ne ishim... familja e Enverit dhe familja ime... Fëmijët e mi ishin shumë të vegjël. E para lindi në 1980, e dyta në fund të '81-shit. Shumë të vegjël. Dhe kishte shumë frikë në komunitet. Familja e Enverit, si edhe e jona, shpesh kontrollohej nga policë të armatosur, duke menduar se ndoshta ishim të përfshirë në aktivitetet terroriste...

Anna Di Lellio: Po flisni për policinë belge?

Kimete Mitrovica Basha: Po. Kishte pasur një sulm të vogël ndaj ambasadës jugosllave, asgjë serioze, por papritur familja e Enverit dhe familja ime u bastisën me automatikë, me njerëz që kontrollonin çdo gjë. Jo një herë, por disa herë.

Dhe një nga ato herë, një nga përfaqësuesit e shërbimeve të sigurisë së Belgjikës, ai është, nuk do t'ia përmend emrin, por ai erdhi në shtëpinë tonë ndërsa këta, këta të armatosur... lloj tjetër njerëzish po kontrollonin dokumentet tona, dhe ai u ul me mua dhe me Ydrizin, dhe unë po përipiqesha, e dini, ta mbaja larg fëmijëve të mi. Dhe ai thotë: "Epo," tha, në mënyrë krejt të zakonshme, kështu, sikur po bisedonim, e dini, e tha fare natyrshëm, tha, e dini, "Epo, e dini, shqiptarët mendojnë se jugosllavët do t'ju vrasin." Këtë po ia thotë burrit tim, "Do t'ju bëjnë atentat. Dhe jugosllavët janë të sigurt se shqiptarët do t'ju bëjnë atentat."

Unë jam ulur aty, pikërisht aty. Dhe ai thotë: "Por e dini çfarë? Unë mendoj se ju do t'ia dilni disi, disi do t'ia dilni, sepse asnjëra palë... do të presin njëra-tjetrën, kështu që ju do t'ia dilni." Dhe shton: "Nuk jam aq i sigurt për Enver Hadrin." Këtë tha. Dhe unë thashë: "Ju lutem? Po flisni për jetët e njerëzve këtu. Ata kanë familje, kanë fëmijë." "Unë po ju them siç është." I shkujdesur, i pandjeshëm, e dini, krejtësisht i pandjeshëm ndaj asaj që po thoshte. M'u duk e pabesueshme.

Dhe kështu, duke e çuar përpara kohën, e vranë. E vranë atje. Dhe e vranë një natë. Dhe ne ishim në shtëpi. Dhe atë mbrëmje kishim mysafirë. Për ndonjë arsye, Ydrizi këmbënguli që të shikonim lajmet, lajmet e orës shtatë. Tha: "Jo, sepse po ndodhin shumë gjëra..." Ai kurrë nuk donte t'i humbiste lajmet. Kështu që shkuam në bibliotekë dhe ndezëm televizorin. Dhe aty ishte, Enveri, e dini, nuk e thonë drejtpërdrejt, "Enveri vdiq." Ata thonë, e dini, "Opozita, kjo dhe ajo."

O Zot! Më ra të fikët. U pushtova nga emocionet (me sy të përlotur). Ai ishte miku im. Dhe ishte kolegu im. Kishim, e dini, kishim ndarë mollë bashkë, sepse nuk kishim mjaft para për të blerë ushqim. Kur ishim në Strasburg, blinim mollë për t'i ngrënë bashkë dhe djathë, sepse vërtet nuk kishim para. Ky ishte njeriu që ne... ata e kishin vranë. Dhe kjo më tronditi thellë. Dhe brenda sekondash, unë disi, e dini... dhe pastaj unë... Dhe pastaj gjëja tjetër që po mendoja ishte...

Që nga ajo ditë, për vite me radhë, nuk ecëm më kurrë bashkë në rrugë. Ai ose ecte shumë përpara, ose shumë pas nesh. Gjithmonë ishte frika: mund të ndodhë. Pastaj ndodhi edhe diçka tjetër. Një ditë, ndërsa Ydrizi po parkonte makinën, makina filloi të lëvizte. Unë nuk di të ngas makinën, po përipiqesha ta ndaloja. Ishte fat që ndodhi në parkim. Kur e kontrolluan, zbuluan se frenat ishin sabotuar. Ishte fat që nuk ndodhi në rrugë. Nga ajo ditë, nuk patëm më makinë. Kurrë më. Janë gjëra të vogla që ndryshojnë jetën. Dhe të gjitha erdhën pas vrasjes së Enverit.

Dhe kjo është gjithashtu vërtet e rëndësishme. Ne jetojmë në një botë ku gjërat nuk janë reale. Dëgjojmë për vdekje çdo ditë në Ukrainë, ato nuk janë, janë larg, janë abstraksione. Por në atë moment, gjërat bëhen vërtet reale. Dhe mendova, o Zot! Vajzat e mia ishin aty brenda, si 10, 11 vjeçe. Ato mund të mbeteshin pa babanë e tyre, një fat me të cilin Teuta u përball gjatë gjithë jetës së saj, e kupton. Çfarë do të thotë kjo? Kjo mund t'i ndodhë edhe atij. Dhe që nga ajo ditë, unë dhe Ydrizi nuk

ecëm më kurrë bashkë në rrugë, jo për vite e vite e vite. Nëse ishim diku me fëmijët, ai ose ecte shumë mbrapa nesh ose shumë përpara nesh.

Gjithmonë është kjo gjë: që mund të ndodhë. Kaloi. Kaloi. E di, kaloi. Por për vite me radhë, ishte kështu, ai nuk do, nuk do, nuk donte të na vinte në asnjë rrezik. E hoqëm makinën. Makina ime... Kishim një makinë. Dhe një ditë isha në makinë, Ydrizi doli nga makina dhe ajo, filloi të lëvizte. Dhe unë... unë nuk ngas makinë (qesh), kështu që po përpiqesha ta tërhiqja këtë gjë dhe papritur ajo, e di, thjesht po rrokullisej, e di, si duke u rrokullisur. Dhe pastaj sigurisht, u ndal dhe Ydrizi hyri brenda dhe nuk mund ta kuptonim çfarë kishte ndodhur. Kështu që thirrëm njerëzit të vinin dhe ta kontrollonin makinën, dolëm prej saj. Epo, sigurisht, i kishin ndërhyrë frenave. Ishte fat që kjo kishte ndodhur pikërisht ndërsa ai po parkonte. Kështu që nuk vozitëm më kurrë. Nuk patëm më kurrë makinë në familje. Kurrë. Gjëra të vogla si këto, që ndikojnë në jetën tënde, që erdhën nga vrasja e Enverit.

Vrasja e Enverit ishte një tronditje e thellë psikologjike dhe emocionale për mua. E zhvendosi realitetin e asaj që po bënim nga abstraktja në reale. Fillova të kuptoja për herë të parë se çfarë ishte në lojë këtu, se kjo nuk ishte thjesht gjestikulim. Kjo ishte, kjo ishte reale. Po përballeshim me një regjim që ishte i aftë për vrasje dhe që do të kishte viktimë. Enveri, fatkeqësisht, pagoi një çmim të lartë.

Por unë u rrita atë ditë. U bëra e kthjellët dhe u bëra, mendoj, një partnere më e mirë për burrin tim. Sepse shpesh mendoja se ai po reagoje tepër. E dini, sikur po jetonte në një film të James Bond-it. Por kuptova se ishte reale. Ishte e gjitha reale. Dhe duhej ta pranoja këtë. Dhe më duhej të kisha guxim tani, sepse e kuptova se mund ta humbisja. Vërtet e kuptova. Morëm kaq shumë kërcënime, kaq shumë letra, kaq shumë gjëra.

Pra, e dini, po, ishte e jashtëzakonshme. Por e dini çfarë? Jam krenare për veten. Kalova nëpër atë luginë, e dini, të errësirës në një farë mënyre. Dhe dola prej saj me ndjesinë se të paktën... më fal, Anna, do ta them këtë sepse e ndiej. Mendoj se gjithë kjo përvojë i dha kuptim jetës sime. Në njëfarë mënyre, kam qenë e bekuar që kam qenë kaq e përkushtuar ndaj kësaj kauze. Sepse një ditë do të vdes. Dhe kur të vdes, do të kem bërë diçka me vlerë.

Anna Di Lellio: Dhe dua të të pyes, pse të mori kaq shumë kohë të shkoje në Kosovë, duke pasur parasysh përkushtimin tënd dhe afërsinë tënde dhe faktin që vjen nga një familje e tillë?

Kimete Mitrovica Basha: Është një pyetje e mirë. Mendoj se, e dini, kur Ydrizi... shumë prej kësaj kishte të bënte me situatën time familjare. Ydrizi... në vitin 1994, pati një rënie. Ra nga katër kate shkallësh. Dhe do të kishte qenë në rregull, sepse asgjë nuk ishte thyer, përveçse kur goditi fundin, goditi murin me kokë. Kështu që dëmi ishte tërësisht neurologjik. Shkëlqimi i tij, sepse ai ishte brilant, neurologu më tha se ai... dhe ky neurolog është bërë mik dhe ka shkruar një hyrje për një libër që vajza ime shkroi për Alzheimer-in.

Ai më tha se shkëlqimi i Ydrizit ishte i tillë sa ai arriti ta maskonte dëmin për një kohë të gjatë, që aftësia e tij ishte reduktuar, por e reduktuar në një nivel që shumica e njerëzve e kanë si aftësi

intelektuale. Pra ai e maskoi për një kohë të gjatë. Gjatë kohës që ishte në ambasadë, mendoj se streset e atyre viteve përshpejtuan rënien.

Dhe kështu, në fillim të viteve 2008, në atë periudhë, u bë e qartë për mua se Ydrizi ishte i paaftë të zgjidhte probleme. Psikologjikisht, neurologjikisht, dëmi po shfaqte shenjat e veta. Kështu që për ta mbrojtur, sepse e njihja mizorinë e shqiptarëve, e mbylla derën time. U kujdesa për të. Dhe po, u sigurova që askush të mos e shihte në atë gjendje, që ky ego të mbetet në imazh, të mbetet i paprekur, imazhi i këtij burri të fuqishëm. Kështu që u përqendrova vetëm tek ai, duke e mbrojtur, duke punuar fort për të paguar faturat.

Kishte shumë fatura, mjekësore dhe të tjera. Kështu që jeta ime u reduktua në mënyrë dramatike në ato vite. Them se në një farë mënyre e vura veten në gjumë. E vura veten në gjumë si aktiviste, si grua, si gjithçka. Punova për ta mbrojtur atë, për t'i mbrojtur vajzat e mia dhe për t'u siguruar që ai të ndihej i sigurt. Ky ishte qëllimi im. Dhe kështu, nuk shkova në Kosovë sepse nuk kisha energji për ta bërë dhe nuk kisha arsye për ta bërë. Në vitin 2016 ai vdiq, dhe disa muaj më vonë isha në Kosovë. Pra më vjen keq që nuk shkova me të. Do të kishte qenë e mrekullueshme, por nuk shkova.

Pjesa e Gjashtë

Anna Di Lellio: Do të na tregosh diçka për vajzat e tua.

Kimete Mitrovica Basha: Po, jam shumë krenare për vajzat e mia. Po, kam dy dhe të dyja kanë mendime të forta dhe janë të përkushtuara për të qenë nëna të mira, por edhe për ta përmbushur veten në mënyrë të pavarur nga roli familjar. Njëra prej tyre është artiste dhe tjetra... artiste, astrologe, mentore. Ajo punon me grupe grash, punon me grupe artistësh. Sarah, më e madhja, është artistja e këtij portreti familjar {tregon kanavacën pas saj}.

Sarah ka një aftësi pothuajse të jashtëzakonshme për t'i lexuar njerëzit. Ka një intuitë të fortë dhe ajo intuitë shpesh është e saktë. Ka një ndjeshmëri ndaj njerëzve dhe i lexon shumë mirë, dhe angazhohet me ta në mënyra interesante dhe shumë pasuruese. Sarah është njeri i njerëzve.

Anna Di Lellio: Është në Londër?

Kimete Mitrovica Basha: Jo, është në Portugali. Ka dy fëmijë të mrekullueshëm. Dhe Sarah, kur i ati vdiq, sepse ishte shumë, shumë e lidhur me të atin. Nuk ka asnjë fotografi ku ata nuk janë duke u prekur. Kishin një marrëdhënie shumë të bukur. Por kur ai vdiq, ajo ishte shtatzënë me fëmijën e saj të parë dhe ishte një kohë shumë e vështirë për të. Por Sarah, dhe duhet ta them, si nëna e saj, vendosi që pikëllimi nuk do të ishte barrë. Do të ishte motor.

Dhe kështu ajo vendosi të shqyrtonte, sepse në fund Ydrizi u trajtua si pacient me Alzheimer. Ai kishte të gjitha karakteristikat e një pacienti me Alzheimer. Ajo u angazhua me një grup njerëzish në një

shtëpi këtu, duke trajtuar pacientë me Alzheimer, për një periudhë trevjeçare. Dhe e bashkoi interesin e saj për artin me kureshtjen për procesin e rënies së njerëzve me demencë dhe Alzheimer. Kështu që për tre vjet punoi në një shtëpi këtu dhe përfundoi duke bërë këtë libër {tregon librin e saj}, të cilin e quajti *What Remains* (Çfarë Mbetet). Sepse ajo përdori fotografi Polaroid.

Dhe ky libër në fakt u prezantua në panairë të ndryshme të librave të artit dhe është vlerësuar shumë në vende të ndryshme. Por ajo që ajo bëri ishte se e kuptoi dhe i dha formë... se kushdo që ka këtë sfidë të tmerrshme, të tmerrshme për ta jetuar, gjithmonë ka diçka që mbetet. Dhe ajo që mbetet pothuajse në, mirë, jo pothuajse, në çdo rrethanë të vetme të njerëzve me të cilët ajo jetoi {e mban librin përsëri} dhe punoi për tre vjet, por edhe në familjen e saj, ajo që mbetet është dashuria.

Çdo person i vetëm mbahet pas një historie dashurie. Mund të jetë dashuria për një instrument, një muzikant, i cili nuk mund të bëjë asgjë tjetër, nuk mund të përqendrohet, nuk mund të mendojë, por ulet para pianos dhe mund të luajë. Mund të jetë dashuria e një fëmije për nënën e tij, duke kujtuar fëmijërinë. Është dashuri. Ydrizi, kur ishte vërtet shumë i humbur, vërtet shumë i humbur, kujtimi i vetëm i qartë që kishte ishte takimi ynë. Dashuria, dashuria mbetet. Kështu që Sarah e bëri këtë.

Dhe Aurélie, historiania jonë, më e vogla, jo aq e hapur, por një grua thellësisht, thellësisht besnike, reflektuese. Sigurisht, ajo është historiane e përqendruar kryesisht në periudhën e Luftës së Ftohtë, periudhën amerikane të Luftës së Ftohtë, dhe magjepsjen e saj me Robert McNamara-n. Sepse interesi i saj është historia ushtarake, çuditërisht. Kështu që ajo shkroi edhe librin e saj. (buzëqesh) {e mban librin}. Dua të them, çdo anëtar i familjes sonë ka shkruar një libër, por ky, *I Made Mistakes*, shqyrton një perspektivë krejtësisht të re mbi periudhën e McNamara-s si Ministër i Mbrojtjes. Dhe që atëherë, ajo është bërë shumë, shumë e afërt me djalin e McNamara-s, Craig, i cili është fermer arrash (qesh). Por edhe ajo e bëri këtë për babanë e saj.

Anna Di Lellio: Dhe cili është titulli i librit?

Kimete Mitrovica Basha: *I Made Mistakes*. Është një frazë nga një fjalim që ai mbajti në Montreal: “I made mistakes, but not the ones people say I did.” (“Kam bërë gabime, por jo ato që njerëzit thonë se kam bërë.”) Dhe në fakt unë e redaktova këtë libër për të, megjithëse zyrtarisht ishin njerëzit e Cambridge University Press.

Por punuam shumë mirë bashkë gjithashtu. Pra, edhe ajo nga sëmundja e babait të saj mori një dëshirë për të bërë diçka, jo thjesht për të qenë diçka. Dhe kështu ajo ia kushtoi këtë libër babait të saj. Aurélie dhe babai i saj kishin një lloj marrëdhënieje tjetër, një marrëdhënie ndryshe. Por ajo që më duket vërtet interesante tani është se ajo shpesh i referohet mësimëve të babait të saj. E dini, babi këtë, babi atë.

Në sfidat e jetës, ajo vazhdimisht i referohet asaj që ai i mësoi për mënyrën se si nuk duhet të komprometosh vlerat dhe gjëra të tilla. Nganjëherë më vjen të them, mirë, edhe nëna ta mësoi këtë. Por të dyja janë shumë... ato morën nga pikëllimi dhe e transformuan.

Dhe e përdorën për të qenë më të mira se më parë, në vend që të dorëzoheshin para errësirës, shkuan drejt dritës. Pra jam shumë krenare për të dyja. Shumë, shumë krenare për vajzat e mia.

Anna Di Lellio: Ashtu siç duhet. The se çdo anëtar i familjes tënde ka shkruar të paktën një libër, por burri yt, sapo më tregove një koleksion vëllimesh.

Kimete Mitrovica Basha: Por ai gjithashtu shkroi, dhe unë e redaktova librin në Shqipëri pas vdekjes së tij – e ribotova – ai gjithashtu shkroi *A History of Albania*, që nuk u pranua kurrë nga botuesit francezë sepse thanë se ishte tepër polemik. Në fakt po mendoj të rikthehem te ai dhe ndoshta të punoj me të.

Dhe ato pesë vëllime i bëmë në Kosovë, por e dini, këto janë artikujt e tij e kështu me radhë. Pra vajzat kanë shkruar... Aurélie po shkruan një libër tjetër tani, dhe unë sapo kam botuar diçka në Kosovë. Pra kishim të drejtë, ne i vlerësojmë librat dhe e vlerësojmë aktin e dokumentimit, e dini, të hedhjes në letër, të mbrojtjes së gjërave.

Anna Di Lellio: Edhe libri yt për çfarë është? Mund të më thuash pak?

Kimete Mitrovica Basha: Epo, e dini, në dukje është një histori jete, por në të vërtetë, pyetjet themelore që Bernardi [bën], është një dialog, është një bisedë.

Anna Di Lellio: Si kjo.

Kimete Mitrovica Basha: Si kjo, saktësisht. Regjistruam biseda si kjo, dhe pastaj nxorëm prej tyre thelbin. Pastaj unë merrja thelbin dhe ndoshta për dy ose tre javë e shqyrtoja më thellë dhe pastaj vazhdonim. Por në thelb është një histori e mirë, pyetja kryesore që Bernardi bëri ishte: pse zgjodhe të jesh shqiptare? Pse nuk zgjodhe të jesh diçka tjetër? Mund të ishe australiane, mund të ishe kanadeze...

Dhe përgjigjja është, duhet një libër i tërë për ta shpjeguar (qesh). Por them se, në thelb, flas për rrugëtimin drejt realizimit se pa atë identitet, unë jam më pak, e kupton, dhe se gjej forcë dhe qëllim në identitetin tim si grua shqiptare, por se ka shumë mënyra për të qenë grua shqiptare dhe se ti mund ta vendosësh këtë vetë. Duhet ta vendosësh vetë dhe duhet t'i qëndrosh besnike, edhe përballë kundërshtive dhe konflikteve që kjo mund të krijojë.

E di, nëse nuk do... Më kujtohet duke qenë këtu në këtë tavolinë, ishte ambasadorja e Shqipërisë, një grua që ishte anëtare e bordit të fondacionit tonë të vogël dhe anëtarë të tjerë të bordit që ishin këtu. Dhe zonja tha: "Oh, por ishte shumë më mirë! A ju kujtohet kur mund të ktheheshit në shtëpi dhe ishte gjithçka, e dini, hynim e dilnim nga shtëpitë tona gjatë ditës..." dhe unë thashë: "Kjo sepse gruaja duhej të rrinte në shtëpi gjithë ditën." Thashë: "Kishte një çmim për t'u paguar për këtë. Nuk jam aq e sigurt se ishte aq më mirë." (qesh)

Ajo u habit pak, por kjo është realiteti. Pra, si e përkufizojmë shqiptarinë tonë, si i japim formë asaj dhe si e mbajmë, është një vendim personal. Dhe nuk duhet të dëgjojmë çfarë na thonë njerëzit se çfarë është një grua e mirë shqiptare. Ka shumë mënyra për të qenë një grua e mirë shqiptare.

Pra, libri është një shqyrtim i pranimit se kjo nuk është vetëm një gjendje, është një zgjedhje. Dhe... kështu që mbulon... por në të njëjtën kohë, mbulon lëvizjen e Kosovës drejt, e dini, dritës (qesh) dhe Shqipërinë gjithashtu, sepse ishim shumë të përfshirë në ato lëvizje demokratike e kështu me radhë. Pra, mendoj se shikon se si jeta ime ndërthuret me historinë. Kjo është, mendoj, në thelb. Ndoshta Bernardi mund ta thotë më bukur.

Anna Di Lellio: Faleminderit shumë. Mendoj se për mua është koha ta mbyllim, por a do të shtojë diçka? Mendoj se ishte një mënyrë shumë e bukur për ta përmbyllur.

Kimete Mitrovica Basha: Dua të them, para së gjithash, sa kënaqësi ka qenë të të takoj. Dhe të lutem vendose këtë në regjistrim, që ti je një fenomen dhe meriton respektin më të lartë. Unë ndihem e impresionuar nga gjërat që ke arritur të bësh për një komunitet që, në thelb, pse do të të interesonte? Por ty të intereson. Dhe jo vetëm që të intereson siç u intereson të gjithëve, por ti bën diçka për këtë. Pra jam shumë krenare që më ke ftuar të jem pjesë e këtij projekti.

Jam mirënjohëse për këtë. Shpresoj që, po, mendoj se kam thënë atë që kisha për të thënë, por a mund të them vetëm një gjë të fundit për gratë? Mendoj se, e dini, ne jemi motori. Ne jemi gjithmonë motori i ndryshimit. Dhe duhet ta pranojmë këtë si sfidë dhe jo si kërcënim. Nuk duhet të na mbyten. Duhet të ngremë zërin, të themi mendimin tonë dhe të zëmë vendin tonë në agorë. Dhe mendoj se ti po i ndihmon gratë ta bëjnë këtë. Pra mendoj se është e mrekullueshme.

Anna Di Lellio: Nuk mund të jem më shumë dakord me ty. Dhe të falënderoj shumë për kohën dhe për gjithçka që the.

Kimete Mitrovica Basha: Faleminderit.